

Prokuroria  
paralajmëron masa të  
ashpra për ruajtjen e  
votës nga "vjedhësit" 1FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", BEDRI HAMZA 1FAQE 4 - 5

## Zgjedhjet i fitojmë ne, vijë të kuqe s'i vëmë askujt

Zyrtari i lartë i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), njëherësh kryetar dege i kësaj partie në Mitrovicë, Bedri Hamza, është shprehur i bindur për fitoren e PDK-së në zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka treguar se këtë qëllim PDK-ja do ta arrijë me program të qartë, me ekip të mirë dhe me Kadri Veselin kandidat për kryeministër. Ministri në detyrë i Financave ka deklaruar se kjo parti është e para në sondazhet më kredibile dhe nuk vendos vija të kuqe për të tjerët. Hamza ka bërë me dije se subjektet e tjera politike i vendosin PDK-së vija të kuqe për të fituar ndonjë votë më tepër. Por, sipas tij, kjo strategji më nuk do t'ju bëjë punë

NISMA SOCIALDEMOKRATE DHE ALEANCA KOSOVA E RE KANË NËNSHKRUAR  
KOALICION PARAZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARE

## Limaj, kandidat për kryeministër i koalicionit Nisma - AKR

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, dhe kryetari i Aleancës Kosova e Re (AKR), Behgjet Pacolli, të premtën kanë zyrtarizuar marrëveshjen e koalicionit parazgjedhor për zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Sipas marrëveshjes së arritur, Fatmir Limaj do t'i prijë listës dhe do të jetë kandidat për kryeministër. Limaj dhe Pacolli e kanë quajtur lajm të mirë për vendin arritjen e këtij koalicioni. Sipas tyre, ky koalicion do të jetë përcaktues për qeverinë e ardhshme



### AKTUALE



KQZ-ja E GATSHME PËR  
ZGJEDHJE, POR BUXHETI  
ENDE NUK I ËSHTË NDARË F. 7

UJËSJELLËSI VAZHDON  
INSPEKTIMIN E RRJETIT NË  
TRI ZONA TË PRISHTINËS F. 6

AGIM BAHTIRI ZYRTARISHT I  
BASHKOHET VETËVENDOSJES F. 3

### EKONOMI

NË MUAJIN KORRIK KOSOVA  
EKSPORTOI MBI 40 MILIONË  
EURO MALLRA F. 8

MBI 3 MILIONË TURISTË NË  
SHQIPËRI, SHUMICA NGA  
KOSOVA DHE MAQEDONIA E  
VERIUT F. 8

### KULTURË

VESELI: DUKE LUFTUAR  
KORRUPSIONIN RRISIM  
BUXHETIN PËR FILMIN DHE  
ARTISTËT F. 6

### SPORT

HUMBJA NDAJ 'NIKLIT',  
E PAPANUESHME PËR  
BALLKANIN F. 20

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

# Udhëheqësit e G-7-s, të gatshëm të përballen me Trumpin

Udhëheqësit e G-7-s po përgatiten të përballen në qytetin turistik bregdetar Biarritz me një president amerikan të njohur për këndvështrimin e tij anti-globalist dhe qëndrimet nganjëherë konfrontuese kundër aleatëve

PARIS, 23 GUSHT - Presidenti amerikan Donald Trump dhe udhëheqësit e Britanisë, Kanadasë, Francës, Gjermanisë, Italisë dhe Japonisë, do të mbledhen në Francë këtë fundjavë për takimin vjetor të Grupit të Shtatë vendeve më të industrializuara, ose G-7. Mikpritësi i takimit, presidenti francez Emmanuel Macron, ka deklaruar se nuk do të ketë deklaratë të përbashkët në fund të takimit për shkak të mosmarrëveshjeve midis presidentit Trump dhe udhëheqësve të tjerë për çështje kyçe, ka njoftuar voa. Qyteti i turistik bregdetar Biarritz po përgatitet për takimin e demokracive më të përparuara të botës të njohur si "Grupi i shtatëshes".

Ndërkohë, udhëheqësit e G-7-ës po përgatiten të përballen me një president amerikan të njohur për këndvështrimin e tij anti-globalist dhe qëndrimet nganjëherë konfrontuese kundër aleatëve, thonë analistët. "Unë kam ndjekur takimet e G-7-s dhe G-8-s për ca kohë dhe kjo është hera e parë që në të vërtetë mund të ndiejë një

lloj nervozizmi", thotë Karoline Postel-Vinay nga Qendra për Studime Ndërkombëtare në Paris.

Në takimin e G-7-s vitin e kaluar në Kuebek, presidenti Donald Trump kërcënoi t'i ndalte marrëdhëniet tregtare me disa vende anëtare, e quajti mikpritësin e tij, kryeministrin Kanadez Justin Trudeau "të dobët" dhe tërhoqi miratimin e tij për një komunikatë të përbashkët.

Presidenti francez Emmanuel Macron deklaroi se nuk do të ketë komunikatë të përbashkët, hera e parë në historinë e G-7-s, duke përmendur si arsye dallimet midis presidentit Trump dhe udhëheqësve të tjerë mbi çështjet si Irani dhe ndryshimet klimatike.

Ky qëndrim në skenën botërore, të cilën disa analistë e shohin si armiqësor, është në përputhje me doktrinën e presidentit Trump "Amerika e para". Kjo mund t'i shërbejë atij politikisht në përpjekjet për t'u rizgjedhur president në vitin 2020. Megjithatë, disa analistë thonë se presidenti Trump është parë



si një forcë përçarëse në forumet ndërkombëtare. "Kur Shtetet e Bashkuara udhëheqin këto forume, ata mund të realizojnë gjëra. Kur Shtetet e Bashkuara nuk marrin rol udhëheqës ose nuk janë të interesuara, atëherë është shumë e vështirë që të arrihet ndonjë gjë. Unë mendoj se kjo ka qenë shumë e theksuar në takimet e fundit të G-7-s dhe G-20-s", thonë analistët.

Ankthi i udhëheqësve të G-7-s lidhur me presidentin Trump nënvizon pasiguritë e tyre për rolin në ndryshim të Amerikës në botë, në një kohë kur ekonomia globale po përballlet me

kërcënime nga recesioni. "Që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore, ne ishim mësuar të kishim një udhëheqës të botës së lirë me të cilën ishim shumë të qetë, dhe tani nuk po e shohim më", thotë Karoline Postel-Vinay nga Qendra për Studime Ndërkombëtare në Paris.

Përpara takimit, presidenti Trump përsëri hodhi idenë për ta rikthyer Rusinë në grup. Ai përsëriti pohimin e tij se përse mendonte që Moska u dëbua nga G-8. "Rusia ia hodhi presidentit Obama. Ata e morën krimenë gjatë mandatit të tij, jo gjatë mandatit tim", tha ai.

Në vitin 2014, anëtarët e G-8-ës pezulluan Rusinë nga grupi për shkak të aneksimin të Krimesë, një territor ukrainas, të cilin Moska akoma e mban nën pushtim.

Rusia nuk ka shprehur dëshirën për t'u rikthyer në grup. Disa analistë e interpretojnë këtë si një lojë të Putinit. "Ata me siguri po mbajnë këtë qëndrim që të duken sikur Uashingtoni po u lutet të kthehen", thotë William Hill i Insitutit Kennan në Qendrën Wilson.

Të mërkurën Macroni tha se ripranimi i Rusisë në grup pa zgjidhjen e krizës së Ukrainës do të ishte një "gabim strategjik".

## Amazona po digjet



PRISHTINË, 23 GUSHT - Teksa zjarret masive në Amazonë mund të çojnë drejt një krizë ndërkombëtare, ato nuk mund të quhen kurrsesi aksidentale. Pjesa dërrmuese e zjarreve janë vendosur në mënyrë të qëllimshme nga fermerët për të pastruar tokën për bagëtitë e tyre. Praktika është në rritje, e inkurajuar edhe nga politika populiste pro biznesit të presidentit brazilian Jair Bolsonaro, i cili mbështetet nga i ashtuquajtur "grupi i viçave" të vendit.

Teksa kjo mund të shihet thjesht si biznes për fermerët brazilianë, pjesa tjetër e botës po sheh e tmerruar.

Pra, për ata që pyesin se si mund të ndihmojnë në shpëtimin e pyllit gjigant të, njohur edhe si "mushkëritë e planetit" për prodhimin e rreth 20% të oksigjenit në botë, përgjigja është e thjeshtë. Hani më pak mish.

Është një ide që Finlanda tashmë e ka instaluar. Të premten ministri i Financave të vendit

nordik bëri thirrje për Bashkimin Evropian që "ta rishikojë me urgjencë mundësinë e ndalimit të importeve të viçit brazilian", duke e lidhur këtë masë me zjarret në Amazonë.

Brazili është eksportuesi më i madh në botë i mishit të viçit, duke siguruar afro 20% të eksporteve totale globale, sipas Departamentit të Bujqësisë së Shteteve të Bashkuara (USDA), një shifër që mund të rritet në vitet e ardhshme.

## Putini urdhëron përgjigje reciproke ndaj SHBA-së


MOSKË, 23 GUSHT - Presidenti rus, Vladimir Putin, i tha Ministrisë së Mbrojtjes, dhe agjencive të tjera qeveritare që të analizojnë kërcënimin e paraqitur nga një test i ri raketash amerikane, dhe të përgatisin një përgjigje reci-

proke.

Shtetet e Bashkuara thanë të hënën se kishin testuar një raketë balistike, që goditi shënjestrën e saj, pas më shumë se 500 kilometra fluturim. Kjo është prova e parë e tillë, që kur Shtetet e Bashkuara u

tërhoqën nga një traktat i kontrollit të armëve me Rusinë. Putini tha se Rusia nuk mund të qëndrojë duarkryq, dhe se planet amerikane për vendosjen e raketave të reja në rajonin e Azisë dhe Paqësorit "ndikojnë në interesat

tona thelbësore, pasi është afër kufijve të Rusisë". "Siç e dini, ne kurrë nuk kemi dashur, nuk duam dhe nuk do të përfshihemi në një garë të kushtueshme, destruktive të armëve", tha Putini.



Nisma Socialdemokrate dhe Aleanca Kosova e Re kanë nënshkruar koalicion parazgjedhor për zgjedhjet e parakohshme parlamentare

# Limaj, kandidat për kryeministër i koalicionit Nisma - AKR

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, dhe kryetari i Aleancës Kosova e Re (AKR), Behgjet Pacolli, të premtën kanë zyrtarizuar marrëveshjen e koalicionit parazgjedhor për zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Sipas marrëveshjes së arritur, Fatmir Limaj do t'i prijë listës dhe do të jetë kandidat për kryeministër. Limaj dhe Pacolli e kanë quajtur lajm të mirë për vendin arritjen e këtij koalicioni. Sipas tyre, ky koalicion do të jetë përcaktues për qeverinë e ardhshme



**EPOKA  
ERE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 23 GUSHT - Nisma Socialdemokrate dhe Aleanca Kosova e Re (AKR) të premtën kanë arritur koalicion parazgjedhor për zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Kryetarët e këtyre dy partive, Fatmir Limaj dhe Behgjet Pacolli, në një konferencë për medie kanë nënshkruar marrëveshjen e partneritetit, duke vlerësuar se ky koalicion do të jetë një alternativë e mirë për qytetarët në zgjedhjet e parakohshme. Lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë se arritja e këtij koalicioni është lajm i mirë për Kosovën. Sipas tij, këto dy parti kanë bashkuar forcat për të kryer punë të mira për vendin. Limaj ka bërë me dije se do t'i prijë listës dhe do të jetë kandidat për kryeministër. "Besoj se

është një lajm i mirë për vendin dhe për zhvillimet politike. Një lajm që tregon se po ndërtojmë një bosht politik rreth të cilit presim që të bashkohen edhe grupet e tjera politike. Është e rëndësishme të kemi një frymë pozitive dhe qytetarët ta kenë mundësinë ta kenë zgjedhjen e vet. Koalicioni parazgjedhor Nisma - AKR e jep një mundësi të tillë. Do ta thellojmë bashkëpunimin për të kryer punë të mira për vendin. Koalicioni Nisma-AKR i ka dyert e hapura edhe për grupe të tjera që janë të interesuara t'i bashkohen këtij boshti politik. Kam nderin që do t'i prijë listës dhe do të jem kandidat për kryeministër i koalicionit për këto zgjedhje", ka deklaruar Limaj.

Ai ka thënë se koalicioni parazgjedhor Nisma-AKR do të jetë përcaktues për qeverinë e ardhshme. Sipas Limajt, ky koalicion është shumë më i

natyrshëm dhe më i përafërt se sa shumë koalicione që kanë ndodhur dhe mund të ndodhin. "Ju siguroj se ne si grupe politike po ruajmë balanca politike dhe po ndihmojmë për krijimin e një alternativë ndryshe e cila do të bazohet dhe do ta shpalosë fushatën e vet në çështje thelbësore dhe të rëndësishme për vendin. Nuk do të biem viktimë e një vote më tepër elektorale për t'u marrë me temat që nuk kanë mbulesë dhe janë të panevojshme. Do të përqendrohemi në temat të cilat e presin vendin dhe të gjithë e dinë se Kosovës i duhet një qeveri e fuqishme. Kosova ka tema me të cilat duhet të merret seriozisht. Qysh nga sot mund të them se

Nisma dhe AKR-ja do të jenë faktorët kryesorë në qeverisjen e ardhshme. Pra, ky koalicion do të jetë përcaktues i qeverisë së ardhshme. Po i bashkojmë forcat jo vetëm për dy partitë tona, por me këtë po e bëjmë një gjest të madh për vendin tonë", është shprehur Limaj, duke hedhur poshtë mundësinë që ky koalicion t'i bashkohet PDK-së. "Partitë e vogla mund t'i bashkohen këtij boshti politik. Koalicioni Nisma-AKR shkon i vetëm në zgjedhje. Ky koalicion është shumë më i natyrshëm dhe më i përafërt sesa shumë koalicione që kanë ndodhur dhe mund të ndodhin", ka theksuar Limaj.

Ndërsa kryetari i Aleancës Kosova e Re, Behgjet Pacolli, koalicionin e sapoarritur e ka quajtur qendra e artë. "AKR-ja dhe Nisma mbrëmë (e enjte) kanë vendosur që të formojnë një koalicion të cilin do ta quaja qendra e artë ose pjesa e tretë politike, e cila do të jetë kyçe për formimin e qeverisë së ardhshme. AKR-ja dhe Nisma do të jenë në koalicion parazgjedhor dhe do të garojnë me një listë të përbashkët. Lista do ta ketë kandidatin e vet për kryeministër", ka deklaruar Pacolli duke shtuar se AKR-ja dhe Nisma do të bëjnë një punë dinjitoze për vendin

dhe qytetarët. "Kam pasur bashkëpunim shumë të mirë me z. Limaj dhe ministrat e Nismës dhe kemi qenë një zë i punës së mirë duke dërguar mesazhe të mira nga Qeveria e Kosovës. Kemi punuar në mënyrë të ndershme dhe transparente dhe këtë mandat, i cili, edhe pse nuk ka shkuar deri në fund, e kemi kryer në mënyrë dinjitoze dhe pa asnjë skandal. Askush nuk mund ta drejtojë gishtin kundër punës sonë dhe jam krenar me punën që e kemi bërë", ka theksuar Pacolli, duke shtuar se koalicioni Nisma - AKR do ta ketë në rend të parë qytetarin dhe hallet e tij. "Kemi pasur bashkëpunim të mirë në qeverinë e kaluar dhe besojmë se edhe në të ardhmen do të bëjmë një punë të mirë. AKR-ja dhe Nisma do të jenë në mbështetje të qytetarëve", është shprehur Pacolli. Ai ka folur edhe për paralajmërimin e zëvendëskryetari Agim Bahtiri nga partia, me ç'rast ka thënë se AKR-ja ka qenë, është dhe do të ekzistojë edhe më tutje.

Koalicioni në mes të Nismës dhe AKR-së është koalicioni i dytë parazgjedhor i arritur në Kosovë. Këtë javë koalicion parazgjedhor kanë bërë edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Partia Socialdemokrate (PSD).



## Agim Bahtiri zyrtarisht i bashkohet Vetëvendosjes

PRISHTINË, 23 GUSHT - Kryetari i Mitrovicës nga radhët e Aleancës Kosova e Re (AKR), Agim Bahtiri, së bashku me qindra aktivistë të AKR-së, të premtën i është bashkuar Lëvizjes Vetëvendosje (LV). Pas bashkimit me LV-në, Bahtiri ka thënë se Albin Kurtin e ka mik të zemrës. Ai ka falënderuar aktivistët e AKR-së për mbështetjen që i kanë dhënë për të mirën e Mitrovicës. Por Bahtiri ka kritikuar institucionet qen-

drore duke thënë se nuk e kanë përkrahur punën e tij në Mitrovicë.

Në ceremoninë e aderimit të Bahtirit në Vetëvendosje ka qenë i pranishëm edhe kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti. Ai ka vlerësuar qeverisjen e Bahtirit në Mitrovicë dhe ka thënë se falë tij sot nuk është kufiri te lumi Ibër. "Duke iu falënderuar qëndresës së kryetarit Bahtiri, sot nuk e kemi

kufirin në lumin Ibër", ka thënë Kurti, duke shtuar se dita e zgjedhjeve do të jetë ditë e fitores. "Jemi të bindur që bashkë me Agim Bahtirin dhe aktivistët e tjerë të AKR-së ditën e zgjedhjeve do ta shndërrojmë në ditë fitoreje e ditë feste", është shprehur Kurti.

Agim Bahtiri ka qenë zëvendëskryetar i AKR-së dhe që dy mandate është kryetar i Mitrovicës.



Flet për "Epokën e re", Bedri Hamza

# Zgjedhjet i fitojmë ne, vijë

Zyrtari i lartë i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), njëherësh kryetar dege i kësaj partie në Mitrovicë, Bedri Hamza, është shprehur i bindur për fitoren e PDK-së në zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka treguar se këtë qëllim PDK-ja do ta arrijë me program të qartë, me ekip të mirë dhe me Kadri Veselin kandidat për kryeministër. Ministri në detyrë i Financave ka deklaruar se kjo parti është e para në sondazhet më kredibile dhe nuk vendos vija të kuqe për të tjerët. Hamza ka bërë me dije se subjektet e tjera politike i vendosin PDK-së vija të kuqe për të fituar ndonjë votë më tepër. Por, sipas tij, kjo strategji më nuk do t'ju bëjë punë

**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 23 GUSHT -

**"Epoka e re":** Z. Hamza, me vota të pozitës dhe të opozitës Kuvendi është shpërndarë. Cili është vlerësimi juaj për këtë legjislaturë?

**Hamza:** Kjo legjislaturë ka bërë disa punë të mira. Megjithatë, ka pasur mundësi të bëjë më shumë qeveria dhe Kuvendi. Nuk po flas në raport me nevojat, sepse nevojat e vendit janë shumë të mëdha. Po flas në raport me mundësitë. Ka pasur mundësi të bëhet më shumë. Kuvendi ka pasur mundësi të kishte produktivitet më të madh duke aprovuar numër më të madh të ligjeve, mirëpo shumë seanca kanë qenë të jashtëzakonshme me tema të caktuara, të thirrura edhe nga opozita, të cilat kanë ndikuar në punën e Kuvendit. Besoj se përbërja e ardhshme e Kuvendit, formati i ri i qeverisë, do të ketë një produktivitet dhe efikasitet më të lartë sesa ka qenë në këtë mandat.

**"Epoka e re":** Po qeveria, sa i ka përmbytur pritjet tuaja dhe të PDK-së për këtë mandat?

**Hamza:** Në segmente të caktuara ka pasur përparim. Nëse i referohemi rritjes ekonomike, rritja ekonomike për vitin 2017 ka qenë 4.2 për qind, që është më e madhe se rritja në qeverinë paraprake. Nëse qeveria paraprake është mbyllur me rritjen ekonomike prej 4.1 përqindësh, rritja ekonomike 4.2 për qind është më e larta. Për vitin 2018 presim vlerësime zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Sipas vlerësimeve tona, del se rritja ekonomike ka qenë 4.3 për qind, pra është një rritje më e madhe sesa në periudhën

paraprake. Sa i përket stabilitetit makrofiskal, vendi ka përmirësuar stabilitetin makrofiskal. Së fundi e dëgjova një deklaratë të liderit të Vetëvendosjes për deficit buxhetor, e cila ishte krejtësisht joprofesionale dhe e paqëndrueshme. Nëse i referohemi periudhës shtatëmuajore të këtij viti, ne jo se kemi deficit, por kemi suficit, që do të thotë se kemi mbledhje të të hyrave më shumë sesa që kemi shpenzuar. Vendi asnjëherë nuk e ka pasur likuiditetin më të mirë. Aktualisht bilanci bankar është mbi 700 milionë euro, që është rreth 10 për qind e brutoproduktit vendor dhe i cili garanton që të kryhen të gjitha obligimet ligjore në kohë. Asnjëherë nuk ka pasur vonesa për ekzekutimin e pagave, apo pensione, dhe nuk ka asnjë arsye të qëndrueshme që organizatat buxhetore të kenë vonesa në pagesa për punët e kryera. Përtej kësaj, i inkurajoj organizatat buxhetore ta bëjnë dinamizmin e ekzekutimit të projekteve kapitale.

Pra, vendi ka pozitë të qëndrueshme dhe stabilitet makrofiskal. Nëse e shikojmë buxhetin nga 1.7 miliard sa ka qenë në pjesën e ekzekutivit në vitin 2017, këtë vit ne kemi arritur të kemi buxhet prej 2.4 miliardësh dhe buxhet me burime të qëndrueshme të financimit.

Tash se a shpenzohen apo nuk shpenzohen është çështje e organizatave buxhetore, por financimi është 100 për qind i sigurt. Trendi i të hyrave është i mirë. Në Administratën Tatimore për këtë periudhë të vitit të hyrat janë diku 11 për qind më shumë sesa në vitin paraprak, Dogana po e mban një trend 4 deri në 5 për qind, dhe pres që deri në fund të vitit plani i të hyrave në



përgjithësi të përmbushet rreth 98-99 për qind, që është një përmbushje jashtëzakonisht e mirë. Janë kryer edhe punë të tjera të mira. Për këtë mandat kemi përfituar mbi 200 milionë euro grante, pa kthim para, për projekte të ndryshme në Kosovës. Kjo ka ndodhur si rezultat i ruajtjes së qëndrueshmërisë dhe stabilitetit makrofiskal, por edhe si rezultat i një bashkëpunimi të mirë dhe konkurrimit me projekte të përgatitura mirë. Kemi siguruar financimin edhe për rrugën për Pejë dhe për rrugën për Mitrovicë, si dhe kemi siguruar financim edhe për shumë projekte të tjera në arsim, shëndetësi, bujqësi e kështu me radhë. Jemi të vetëdijshëm se ka vonesa në disa projekte, sidomos në rrugën Prishtinë - Pejë. Kjo rrugë ka studimin e fizibilitetit dhe dizajnin detal teknik dhe ka

financimin e sigurt. E dimë se çfarë rëndësie ka kjo rrugë për rrafshin e Dukagjinit. Po ashtu, vlen të përmendet rritja e pensioneve kontributdhënëse me 15 për qind dhe pensione bazike me 20 për qind. Për herë të parë është fituar financimi i skemës së viktimave të dhunës seksuale. Ka qenë gabim që në qeverinë paraprake janë aprovuar ligjet, por nuk janë buxhetuar tri kategori të reja, siç janë personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, personat e paaftësuar në vendin e punës dhe viktimat e dhunës seksuale. Pastaj, ka ndodhur rritja e pagave në përputhje me rritjen ekonomike. Gjithashtu, ka përfunduar reforma e administratës publike dhe ligjet tashmë janë në fuqi. Pra, të gjitha këto kanë ndodhur duke e ruajtur top prioritetin që është stabiliteti makrofiskal duke mos përjashtu-

ar që niveli i investimeve kapitale me financim të sigurt është mbi 800 milionë.

**"Epoka e re":** Meqenëse tani ka mbetur vetëm të caktohet data e zgjedhjeve nga presidenti, si do t'ia bëni për ndarjen e buxhetit për KQZ-në? Në mbledhjen e fundit të qeverisë në dorëheqje është zhvilluar një debat rreth kësaj çështje?

**Hamza:** Ndonëse ky vit nuk ka qenë vit zgjedhor, duke u bazuar në përvojën e punës sonë në institucione, kemi ndarë një fond në kuadër të Ministrisë së Financave i cili mund të përdoret në rast nevojë. Pra, në këtë fond janë rreth 20 milionë euro, i cili nuk është vetëm për një qëllim, por edhe për qëllime të tjera. Mirëpo në rast nevojë, mbi bazën e nenit 15, paragrafit 2 dhe 7 të ligjit, ministri i Financave ka të

# të kuqe s'i vëmë askujt



drejtë të bëjë transferimin e këtyre mjeteve në cilëndo kategori ekonomike dhe në cilëndo organizatë buxhetore. Pasi kryeministri i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, ne jemi në përgjigje të kësaj gjykate dhe mbi bazën e përgjigjes së Gjykatës Kushtetuese do t'i kryejmë të gjitha veprimet e nevojshme. Kemi marrë një draft-kërkesë nga KQZ-ja dhe PZAP-ja për buxhetin që u nevojitet për këto zgjedhje. Nuk është shumë e cila nuk mund të mbulohet, mirëpo vetëm po presim qartësim të situatës juridike.

**"Epoka e re":** Sa është përgatitur PDK-ja për këto zgjedhje?

**Hamza:** PDK-ja për këto zgjedhje është përgatitur jashtëzakonisht mirë. Ne kemi përfunduar procesin zgjedhor në të cilin ka pasur në pjesëmarrje masive.

Jemi parti e konsoliduar, kemi shtrijë në tërë territorin e Kosovës dhe kemi ndërtuar një strukturë të fuqishme, duke filluar prej nëndegëve, degëve dhe nivelin qendror. Janë krijuar shtabet zgjedhore dhe janë identifikuar njerëzit përgjegjës të procesit dhe aktivistët. Po ashtu, PDK-ja ka një program jashtëzakonisht të mirë dhe shumë konkret, të cilin besoj se kryetari Veseli do ta shpalosë në ditët e ardhshme.

Jam optimist se zgjedhjet dhe procesi zgjedhor do të shkojnë mirë dhe jam i sigurt se PDK-ja do të vazhdojë të jetë partia e parë në Kosovë. Po dëgjoj shumë analistë e oponentë politikë që po thonë se PDK-ja ka qeverisur gjatë dhe duhet të shkojë në opozitë. Por, ky nuk është kurrfarë argumenti. Merreni për shembull Holandën, Austrinë,

Gjermaninë apo shtetet e tjera dhe shihni se në këto shtete jetëgjatësinë në pushtet të një parti politike nuk e përcaktojnë oponentët e saj politikë, por qytetarët. Prandaj, edhe PDK-ja do të qeverisë aq gjatë sa e fiton besimin e qytetarëve të Kosovës. Po ashtu, kam dëgjuar edhe tjetrën: se nuk do t'i japim më shansin PDK-së. Dy herë PDK-ja si partia e parë e ka marrë LDK-në në koalicion, në zgjedhjet e vitit 2007 dhe në ato të vitit 2014. PDK-në deri më tani nuk e ka marrë në koalicion askush, PDK-ja i ka marrë të tjerët në koalicion. Pra, qëllimi ynë është t'i fitojmë sërish zgjedhjet dhe për këtë qëllim jemi fokusuar në program, ekip dhe me kryetarin Veseli si kandidat për kryeministër do të jemi të sigurt në fitore. Kjo do të ndodhë edhe si rezultat i punëve

që i kemi bërë në të kaluarën. Nuk them se gjatë qeverisjes kemi qenë pa gabime, por do të përmirësohemi vazhdimisht dhe në këtë drejtim kryetari Veseli ka dhënë shembullin se si duhet të shkohet përpara.

**"Epoka e re":** Deri më tani pothuajse të gjitha partitë i kanë vendosur PDK-së vija të kuqe. Cila është përgjigja e PDK-së ndaj këtyre vijave?

**Hamza:** PDK-ja nuk vendos vija të kuqe për askënd, sepse ne jemi të fokusuar për t'i fituar zgjedhjet. Si fitues të zgjedhjeve e kemi të drejtën e krijimit të qeverisë dhe pastaj, mbi bazën e rezultateve të zgjedhjeve, ulemi dhe e diskutojmë çështjen e programeve dhe të gjitha elementet e tjera. I kuptoj qëndrimet e oponentëve tanë politikë, sepse ata e dinë fuqinë e PDK-së, e

njohin organizimin dhe strukturën tonë dhe, normalisht se i frikësohen PDK-së. Qëllimi i këtyre qëndrimeve të partive të tjera ndaj PDK-së bëhet për të fituar ndonjë votë, por ka kaluar koha kur individë të caktuar jo që kanë qenë vlerë e shtuar për parti të caktuara, por brenda atyre partive e kanë rritur votën e vet duke u marrë me PDK-në. Besoj se kjo çështje i takon së kaluarës dhe është mirë që partitë të garojnë në zgjedhje me programe, ekip dhe lider.

**"Epoka e re":** Sondazhet e publikuara deri më tani nuk e nxjerrin mirë PDK-në. A keni bërë ndonjë sondazh të brendshëm?

**Hamza:** Natyrisht se edhe ne i kemi sondazhet dhe janë shumë të besueshme. Në bazë të këtyre sondazheve ne jemi të parët. Ata që po thirren në disa sondazhe po tregohen shumë qesharakë, sepse nuk është ashtu siç po thonë. Pra, PDK-ja është partia e parë dhe do të vazhdojë të jetë parti e parë. Tani e tutje vetëm do të shkojë duke i rritur.

**"Epoka e re":** Deri më tani janë bërë dy koalicione parazgjedhore: AAK-PSD dhe Nisma-AKR. PDK-ja, a ka menduar për ndonjë koalicion parazgjedhor?

**Hamza:** Ne jemi të gatshëm të shkojmë edhe vetëm në zgjedhje. Mirëpo kjo nuk do të thotë se e kemi mbyllur çështjen e koalicioneve. Në çfarëdo opsioni ne jemi të gatshëm për zgjedhje.

**"Epoka e re":** Shumëkush mendon se për t'ua shkrirë vijat e kuqe të tjerëve, PDK-ja mund t'ia ofrojë ndonjë partie postin e kryeministrit sikurse ka ndodhur herën e fundit.

**Hamza:** Jo. Mendoj se z. Veseli përfundimisht do të jetë kandidati ynë për atë post dhe kryeministër i ardhshëm i Kosovës. Jam i bindur se është në interes të vendit që partia fituese ta ketë postin e kryeministrit.

**"Epoka e re":** Cila do të jetë oferta kryesore e PDK-së në këto zgjedhje?

**Hamza:** Fillimisht programin do ta shpalosë kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, i cili do t'i prezantojë vijat e trasha të programit. Ai është një program i përgatitur mirë, i cili është në përputhje me realitetin dhe nevojat e Kosovës, duke marrë në konsideratë specifikat e Kosovës. Pra, programi e prek pjesën e rendit dhe ligjit, zhvillimin ekonomik dhe segmentet sociale. Është një program i kombinuar shumë mirë, real dhe racional.

# Veseli: Duke luftuar korrupsionin rrisim buxhetin për filmin dhe artistët

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 23 GUSHT - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, i shoqëruar nga ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka vizituar të premtën Qendrën Kinematografike të Kosovës, një institucion ky i cili me përkrahjen e ministrit të Kulturës ka dyfishuar buxhetin dhe ka mbështetur projekte të reja. Kreu i PDK-së u informua nga përfaqësuesit e Qendrës Kinematografike për ndryshimet e mëdha që kanë

bërë si rezultat i punës së ministrit Kujtim Gashi nëpërmjet luftimit të korrupsionit. "Isha shumë i kënaqur nga ajo që e potencuat. Do të thotë, kemi përmirësim të kushteve të punës, kemi rritje të pagave dhe kemi pothuajse dyfishim të buxhetit. Dhe a e dini nga kanë ardhur? Një pjesë e këtyre parave kanë qenë aty, por janë abuzuar. Atë që ka bërë ministri është se e ka shfrytëzuar atë para publike në mënyrë më të drejtë. Me paratë që ndoshta janë abuzuar në xhirollogari të ndryshme, tani është rritur përgjegjësia dhe me të njëjtat

para kemi arritur t'i rrisim pagat, të dyfishohet buxheti i Qendrës Kinematografike dhe të kemi perspektivë për arsye se tani shihet se ka menaxhim më të mirë dhe mund të investohet më shumë. Pra, po del se lufta kundër korrupsionit nuk është vetëm e drejtë, por është edhe e vlefshme", ka thënë Veseli. Ministri i Kulturës, Kujtim Gashi, ka thënë se me përkrahjen e Veselit deri në fund të këtij viti buxheti i Qendrës Kinematografike do të rritet për 200 për qind. "Ajo që na ka mundësuar rritjen e buxhetit dhe shtimin e financimit të

shumë më shumë filmave sesa më parë, ka qenë vënia e kontrollit të rreptë të buxhetit, kursimet dhe pastaj rritja e buxhetit për institucionet kulturore. Ajo që është e rëndësishme, tani për herë të parë kemi pasur financim të një numri të madh të filmave përmes Qendrës Kinematografike të Kosovës", ka thënë Gashi. Arben Zharku, drejtor i Qendrës Kinematografike të Kosovës, tha se falë mbështetjes së madhe të ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, u është dyfishuar buxheti në vitin 2019 dhe tani

Kosova po hyn në etapën e bashkëpunimeve të reja me vendet perëndimore që kompani të mëdha filmike të vijnë e të realizojnë filma në vendin tonë. "Buxheti ynë tashmë është dyfishuar. Ministri nuk ka pranuar rritje më të vogla. Kjo ka ndikuar shumë që të mbështesim më shumë projekte, por edhe e ka rritur praninë tonë ndërkombëtare. Besoj e keni vërejtur që filmi kohët e fundit na ka sjellë shumë lajme të mira dhe përmes filmit kemi arritur ta tregojmë rrëfimin tonë për vendin tonë", ka deklaruar Zharku.



## Ujësjellësi vazhdon inspektimin e rrjetit në tri zona të Prishtinës



PRISHTINË, 23 GUSHT (ER) - Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina" u ka kërkuar falje konsumatorëve që jetojnë në pjesën e re të lagjes "Arbëria", "Dardania" dhe "Kalabria", të cilat lagje linjën furnizuese e kanë nga rezervuari i Arbërisë në Prishtinë, se po bëhen shtatë ditë detektim dhe inspektim i rrjetit të ujësjellësit për gjetjen e defektit në gypin që i furnizon këto tri lagje me ujë të pijshëm. "Me këtë rast,

kemi humbje të ujit dhe rënie të presionit në katet e larta të lagjeve të lartcekura. E kemi cekur edhe herën e fundit që inspektimi po realizohet nën dyshimin e bazuar në dëmtim nga disa palë të treta, ku ne si ujësjellës nuk jemi duke u informuar me kohë nga palët e tjera, derisa ende nuk po dihet saktësisht natyra e defektit të shkaktuar në atë rrjet", është thënë në njoftimin e Ujësjellësit "Prishtina". Sipas këtij njoftimi,

ekipet e mirëmbajtjes së rrjetit të ujësjellësit janë vazhdimisht në terren duke e bërë të pamundurën për saktësimin e rrjedhjes së ujit dhe janë duke u marrë sistematikisht me këtë problem. "Hap pas hapi, në shumë pusete, ujëmatës zonale dhe rrjetin në përgjithësi, pasi që ky rrjet ka një shtrirje të gjerë dhe vështirësi teknike deri në gjetjen e avarisë", ka njoftuar Ujësjellësi "Prishtina".

## Ministri Ismaili thotë se po përmirësohen kushtet në spitalin e Gjilanit

GJILAN, 23 GUSHT (ER) - Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka prezantuar punimet që po zhvillohen në spitalin e Gjilanit për t'i përmirësuar shërbimet shëndetësore. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", ka shkruar se edhe spitali i këtij qyteti, sikur spitalet

e tjera në Kosovë, ka vuajtur nga mungesa e vëmendjes dhe investimeve. "Edhe Spitali i Përgjithshëm i Gjilanit, sikur spitalet e tjera në Kosovë, ka vuajtur prej mungesës së vëmendjes dhe investimeve. Përveç rinovimit të shërbimit emergjent, kemi nisur edhe rinovimin e objektit të

Ambulancave Specialistike. Gjendja e këtij spitali ende nuk është në nivelin që dëshirojmë ta shohim, por me investimet që po bëhen të mundura falë luftës kundër korrupsionit, shërbimet mjekësore për qytetarët tanë po përmirësohen", ka shkruar Ismaili.



# Prokuroria paralajmëron masa të ashpra për ruajtjen e votës nga 'vjedhësit'

PRISHTINË, 23 GUSHT - Që nga viti 2014 e deri më sot rreth 2 000 persona të Kosovës janë përballur me ligjin për vjedhje të votave dhe keqpërdorimeve në proceset zgjedhore. Njëzetën prej tyre janë dënuar me burg, 42 kanë marrë dënime me gjobë, kurse 1 171 persona të tjerë kanë marrë dënime me kusht.

Në Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) thonë se nuk kanë të dhëna të sakta për zgjedhjet para vitit 2014, sidomos për zgjedhjet e vitit 2010, ku ndodhën vjedhjet më të mëdha të votave që nga mbarim i luftës. Përmes një përgjigje me shkrim për "Radion Evropa e Lirë", KGJK-ja ka sqaruar se çfarë dënime janë shqiptuar deri më tani për personat që kanë vjedhur vota.

"Dënimi më i vogël është me tre muaj burgim, kurse dënimi më i madh me 6 muaj burgim. 1 800 euro është vlera më e lartë e paguar si gjobë nga të dënuarit, ndërsa gjoba më e vogël është 150 euro", thuhet në përgjigje.

Kodi Penal i Kosovës parasheh veprat penale për çdo kënd që dëmton procesin e votimit, për të cilat vepra dënimi është deri në pesë vjet burgim.

Prokurorja Laura Pula, që është edhe koordinatore nacionale për zgjedhje, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se që nga dita kur presidenti do ta shpallë datën e zgjedhjeve, do të angazhohen maksimalisht

për ruajtjen e votës së qytetarëve. "Sipas Kodit Penal, veprat penale parashihen që nga data kur fillon fushata e deri në ditën e numërimit të votave dhe janë të përfshira diku 11 vepra penale që kanë të bëjnë me të drejtën e votimit. Kështu që njëjtë do të jemi aktivë sikurse në zgjedhjet e kaluara, me qëllimin e vetëm që ta mbrojmë votën e lirë të qytetarit", ka thënë Pula.

Organizatrat që merren me monitorimin e zgjedhjeve, por edhe të proceseve gjyqësore, vlerësojnë se proceset zgjedhore në Kosovë që nga pas lufta janë dëmtuar nga partitë politike dhe militantët e tyre. Deri më sot në Kosovë askush s'është dënuar me kaq vite burgim për vjedhje të votës.

## Votimi nga të vdekurit

Hyrije Mehmeti nga Instituti i Kosovës për Drejtësi ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se gjatë monitorimit të zgjedhjeve përgjatë viteve ka pasur shumë raste kur kanë votuar edhe të vdekurit. Ajo ka pohuar se prokurorët kanë dështuar t'i nxjerrin para drejtësisë organizatorët e vjedhjes së votës. "Bazuar në monitorimin e IKD-së, shikuar në tërësi, sistemi i drejtësisë ka vepruar në mënyrë reaktive dhe joproaktive për ndjekjen e rasteve të keqpërdorimeve në zgjedhje. Dhe ajo që është më shqetësuese është se



prokurorët kanë dështuar t'i ndjekin udhëheqësit, organizatorët, shtytësit dhe financuesit e vjedhjes së votave, por janë mjaftuar vazhdimisht me aktakuzat e ngritura ndaj komisionarëve të partive politike", është shprehur Mehmeti.

Kurse gjykatësit, sipas saj, kanë dështuar t'i trajtojnë këto raste në kohë të arsyeshme. "Monitoruesit e IKD-së ende monitorojnë rastet gjyqësore për zgjedhjet e vitit 2010, pra tek pas 8-9 vjetësh kanë filluar disa prej këtyre rasteve të gjykohen", ka thënë ajo.

Fajin për vjedhjet e votave, sipas drejtoreshës së Grupit për Studime Juridike dhe Politike,

Arbresha Loxha, e kanë vetë partitë politike. "Ne po konsiderojmë se është parimore të ketë pajtim të plotë mes partive politike që asnjëra nuk ka në plan dhe as nuk të do të lejojë të manipulohet procesi zgjedhor. Pavarësisht prej mobilizimit të institucioneve të Kosovës apo atyre ndërkombëtare dhe organizatave të shoqërisë civile, janë partitë ato që mund ta prishin procesin zgjedhor", ka deklaruar Loxha. Ajo ka theksuar për "Radion Evropa e Lirë" se institucionet e drejtësisë duhet të dërgojnë mesazhe të fuqishme se çfarë i pret ata që vjedhin vota. "Duhet të ketë mobilizim të policisë dhe

prokurorisë, në kuptim që secila prej këtyre institucioneve të dërgojnë mesazhe të qarta për të gjithë ata të cilët tentojnë ta manipulojnë ditën e procesit", ka thënë Loxha.

Kur Kosova është në prag të organizimit të zgjedhjeve të parakohshme pas shpërndarjes së Kuvendit, anëtarët e shoqërisë civile bëjnë thirrje të mos dëmtohet demokracia. Zgjedhjet e parakohshme që pritet të organizohen në muajt në vazhdim, kanë ardhur si pasojë fillimisht e dorëheqjes së Ramush Haradinajt nga posti i kryeministrit, pastaj pas shpërndarjes së Kuvendit të Kosovës.

# KQZ-ja e gatshme për zgjedhje, por buxheti ende nuk i është ndarë

PRISHTINË, 23 GUSHT - Kuvendi i Kosovës u shpërnda këtë të enjte, ndërsa presidenti Hashim Thaçi ka thënë se shumë shpejt do ta shpallë datën e zgjedhjeve. Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve thonë se edhe pse ky vit nuk është paraparë të jetë zgjedhor, janë të gatshëm ta bëjnë organizimin e zgjedhjeve.

Kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka, ka deklaruar se tashmë kanë filluar përgatitjet, por janë ende në pritje të vendimit të presidentit për ta shpallur datën e zgjedhjeve. "KQZ-ja, edhe pse ka zgjedhje të paplanifikuara, e ka obligim t'i organizojë zgjedhjet dhe ne kemi filluar përgatitjet, edhe pse nuk e kemi ende datën. Kur ta kemi datën ne do t'i fillojmë përgatitjet e mirëfillta", ka thënë Daka.

E para e KQZ-së ka pohuar se mjetet për organizimin e

zgjedhjeve ende nuk janë ndarë dhe se ende nuk e di se sa është kostoja e këtyre zgjedhjeve. Daka ka thënë se në momentin e shpalljes së zgjedhjeve do ta përpilojnë kërkesën buxhetore të cilën do t'ia drejtojnë qeverisë në largim. "KQZ-ja në momentin kur ta kemi datën nga presidenti i Republikës do të përpilojë një kërkesë buxhetore dhe do t'i drejtohem qeverisë. Ende nuk kemi ndonjë shifër të saktë sepse jemi në përfundim të llogaritjeve dhe vetëm kur do ta kemi datën, do ta dimë përafërsisht edhe shifrën e saktë të kostonë së zgjedhjeve. Në bazë të llogaritjeve që i bëjmë, gjithmonë kemi pasur buxhet të mjaftueshëm dhe besoj se edhe këtë herë do ta kemi", ka thënë Daka për "EkonomiaOnline".

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare pritet të mbahen më 29 shtator ose më 6 tetor.



# Mbi 3 milionë turistë në Shqipëri, shumica nga Kosova dhe Maqedonia e Veriut

**TIRANË, 23 GUSHT** - Shqipëria është vizituar nga 3.3 milionë turistë të huaj në shtatë muajt e parë të këtij viti. Të dhënat janë bërë publike nga Instituti i Statistikave, i cili ka njoftuar se numri i të huajve për këta shtatë muaj është rritur me 12.4 për qind krahasuar me një vit më parë. Por nga vijnë më së shumti të huajt që

zgjedhin Shqipërinë për të bërë pushime? Sipas INSTAT-it, në vendin e parë qëndrojnë kosovarët. Në shtatë muajt e parë të vitit, Shqipëria u vizitua nga 1 milion e 57 mijë kosovarë me një rritje prej 13.7 për qindësh krahasuar me shtatëmuorin e vitit të kaluar. Pas shqiptarëve të Kosovës, në vendin e dytë renditen shteta-

sit nga Maqedonia e Veriut. Për janar-korrik të këtij viti rezultojnë mbi 372 mijë turistë nga Maqedonia e Veriut që kanë vizituar Shqipërinë me një rritje prej 3.4 për qindësh në vit.

Më pas në listë vijnë grekët, malazezët, anglezët dhe italianët, hyrjet e të cilëve për këtë vit variojnë nga 159 mijë

deri në 311 mijë pushues.

Shumica e vendeve që kanë fluksin më të madh të turistëve në Shqipëri janë ato me numrin më të madh të emigrantëve shqiptarë. Kjo do të thotë se një pjesë e madhe e turistëve që raportohen si të huaj janë shtetas shqiptarë, të pajisur me dokumentet e vendeve ku kanë emigruar.

Kriza politike e kësaj vere, e cila kulmoi me mbajtjen e zgjedhjeve të njëanshme pa opozitën në fund të qershorit, pati krijuar shqetësim për dekurajimin e turistëve të huaj. Por të dhënat e raportuar nga INSTAT-i tregojnë se fluksi i pushuesve nga jashtë ka vazhduar të rritet me ritme dyshifrore.



## Në Londër një hakeri do t'i konfiskohen monedha digjitale në vlerë rreth 1 milion dollarë

**LONDËR, 23 GUSHT** - Një gjykatë në Londër ka urdhëruar të premtën konfiskimin e Bitcoin-it dhe monedhave të tjera digjitale, me vlerë gati 1 milion dollarë nga një haker kompjuterik. Gjykatësja Joanna Korner ka vendosur që shteti mund të konfiskojë shumën e monedhave digjitale nga Grant West, 27

vjeç. West, nga Kenti i Anglisë juglindore, u dënua në maj të vitit të kaluar me mbi 10 vjet burgim në bazë të akuzave të komplotit për mashtrim, posedim të pasurisë kriminale dhe të drogës. "Ai duhet t'i bindet urdhrorit të konfiskimit ose të përballet me katër vjet burg shtesë", ka thënë

Korner. Policia ka njoftuar se West përdori adresa elektronike të rrejshme për sulme ndaj më shumë se 100 kompanive në të gjithë botën, duke vjedhur dhjetëra mijëra detaje financiare të klientëve, përpara se t'i shiste të dhënat në tregjet e paligjshme online.





# Në muajin korrik Kosova eksporto mbi 40 milionë euro mallra

Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka njoftuar se eksporti i mallrave në muajin korrik të këtij ka vlerën 40.4 milionë euro, ndërsa importi ka pasur vlerë 336.8 milionë euro, që është një rritje prej 40.5 përqindësh për eksport dhe një rritje prej 8.6 përqindësh për import, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018



euro, ose 41.3 për qind të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 4.1 përqindësh. Partnerë kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-s janë: Shqipëria (16.7 për qind), Maqedonia (10.8 për qind), Mali i Zi (6.4 për qind) dhe Serbia (6.0 për qind).

Ndërsa importet nga vendet e CEFTA-s në muajin korrik 2019 arritën në 49.2 milionë euro, ose 14.6 për qind të importeve të përgjithshme, me një rënie prej (-40.5 përqindësh). Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Shqipëria (6.8 për qind), Maqedonia (6.8 për qind) dhe Serbia (0.7 për qind). "Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 10.7 milionë euro, ose 26.6 për qind. Si partnerë më të rëndësishëm nga këto vende për eksport vlen të përmenden: India (18.2 për qind) dhe Zvicra (5.0 për qind). Ndërsa importet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 124.4 milionë euro, ose 36.9 për qind. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Turqia (12.1 për qind) dhe Kina (9.7 për qind)", thuhet tutje në njoftimin e ASK-së.

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 23 GUSHT** - Të dhënat nga tregtia e jashtme e mallrave në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar më të lartë për 5.3 për qind në muajin korrik 2019 në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2018, gjegjësisht në vlerë prej 296.3 milionë eurosh, krahasuar me deficitin prej 281.4 milionë eurosh në vitin 2018. Eksporti mbulon importin me 12.0 për qind.

Agjencia e Statistikave të Kosovës njofton se eksporti i mallrave në muajin korrik 2019 kishte vlerën 40.4 milionë euro, ndërsa importi kishte vlerë 336.8 milionë euro, që është një rritje prej 40.5 përqindësh për

eksport dhe një rritje prej 8.6 përqindësh për import, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018. Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit: 37.3 për qind të eksporteve e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 10.9 për qind e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 10.6 për qind e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 8.6 për qind e përbëjnë produktet bimore; 7.3 për qind e përbëjnë produktet minerale; 3.3 për qind e përbëjnë artikujt e ndryshëm të prodhuar; 3 për qind e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike etj.

Ndërsa sipas të dhënave të grupeve kryesore për import e përbëjnë: 15.1 për qind produktet

minerale; 13 për qind makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 12.9 për qind ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 9.5 për qind metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 9 për qind mjetet e transportit; 6.8 për qind produktet e industrisë kimike; 5.9 për qind plastika, goma dhe artikujt prej tyre etj. "Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 13 milionë euro, ose rreth 32.2 për qind e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 69.2 përqindësh. Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE janë: Austria (8.9 për qind),

Gjermania (6.5 për qind), Holanda (4 për qind), Britania e Madhe (2 për qind) etj. Kurse importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 163.1 milionë euro, ose 48.4 për qind e importeve të përgjithshme, me një rritje prej 28.4 përqindësh. Importet me pjesëmarrje më të lartë ishin nga: Gjermania (12.5 për qind), Italia (7.4 për qind), Greqia (4.6 për qind), Bullgaria (3.6 për qind), Polonia (3.1 për qind), Sllovenia (3.1 për qind), etj", thuhet në njoftim. Sipas ASK-së, në muajin korrik 2019 eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s arritën në 16.6 milionë

## Ministrja Ziviq në konferencën ndërkombëtare ministrore për bujqësi në Slloveni



**PTUJ, 23 GUSHT (ER)** - Ministrja në detyrë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Dijana Ziviq, po merr pjesë në konferencën ndërkombëtare ministrore me temë "Forcimi i gjeneratës dhe transferimi i njohurive për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale", e cila po mbahet në Ptuj

në Slloveni. Kjo konferencë, e cila po mbahet në kuadër të Panairit Ndërkombëtar të Bujqësisë dhe Ushqimit, do të fokusohet në forcimin e sistemit të transferimit të njohurive dhe inovacionit në bujqësi me qëllim të përmirësimit të zhvillimit

teknologjik të njësive bujqësore, prezantimit të teknologjive të reja dhe zvogëlimit të ndikimit në mjedis dhe në të gjithë zinxhirin ushqimor. Ministrat e bujqësisë të vendeve anëtare të BE-së, vendeve kandidatë dhe kandidatëve potencialë për praninë në BE, gjatë disku-

timit në këtë konferencë do të shkëmbejnë mendime rreth asaj se si t'i ndihmojnë të rinjtë në fshatra për ta bërë mjedisin më miqësor, në mënyrë që më shumë të rinj të vendosin të jetojnë në zonat rurale dhe të punojnë si fermerë. Gjatë kësaj vizite ministrja Ziviq

do të marrë pjesë edhe në hapjen e Panairit të 57-të Ndërkombëtar të Bujqësisë dhe Ushqimit (AGRA), i cili organizohet nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ushqimit e Sllovenisë, ku do të zhvillojë takime bilaterale me homologët e shteteve pjesëmarrëse në këtë panair.

## Nis asfaltimi i rrugëve në lagjen 'Prekazaj' në Çirez

SKENDERAJ, 23 GUSHT (ER) - Në lagjen "Prekazaj" në Çirez ka nisur asfaltimi i segmenteve brenda kësaj lagueje si rezultat konkret pas kërkesave të banorëve vitin e kaluar gjatë dëgjimeve buxhetore.

Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka thënë se janë 800 metra të

shtrira në pesë segmente apo degëzime, për t'u shtruar me asfalt të ri. Kryetari Jashari ka thënë se po kompletohet infrastruktura rrugore edhe në këtë pjesë të fshatit Çirez. "Deri në prapje të shiritit, që nuk do të vonojë shumë, punë të mbarë punëtorëve", ka thënë kryetari Jashari.



## Fillon ndërtimi i sallës së edukatës fizike në shkollën 'Abedin Bujupi' në Arllat të Drenasit

DRENAS, 23 GUSHT (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, së bashku me zëvendësministrin e Punëve të Brendshme, Isa Xhemajlaj dhe kryetarin e Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, kanë vënë të premten gurthemelin e sallës së edukatës fizike në Shkollën Filllore dhe të Mesme të Ulët "Abedin Bujupi" në Arllat të Drenasit.

Ministri Bytyqi, me këtë rast, u shpreh i kënaqur që po përbushet zotimi i MASHT-it që

shkolla e Arllatit të ketë kushte më të mira për nxënësit. "Kemi një shkollë jashtëzakonisht të mirë këtu në Arllat. Jo vetëm si objekt, por vërtet kjo shkollë ka treguar edhe suksese në cilësinë e arsimit, kështu që edhe sot po kompletohet me infrastrukturë shtesë, pra me sallën e edukatës fizike", ka thënë ministri Bytyqi, duke theksuar se nxënësit tashmë, përveç pjesës së edukimit dhe arsimit, do të kenë edhe një sallë moderne sportive për t'i zhvilluar aktivitetet e tyre.



## Më 27 gusht shënohet 21-vjetori i rënies heroike të dëshmorit Ismet H. Rrahmani

SKENDERAJ, 23 GUSHT (ER) - Me rastin e 21-vjetorit të rënies heroike të ushtarakut të UÇK-së, heroit Ismet H. Rrahmani nga

Aqareva e Drenicës, më 27 gusht, në orën 12:00, në varrezat e dëshmorëve në Aqarevë do të bëhen homazhe dhe do të

vendosen kurora me lule te varri i këtij dëshmori. Pastaj do të vizitohet edhe kulla që mban emrin e tij.

## Arrihet marrëveshja për funksionalizimin e spitalit të Podujevës

PODUJEVË, 23 GUSHT (ER) - Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, dr. Basri Sejdiu, dhe kryetari i Komunës së Podujevës, Agim Veliu, kanë nënshkruar marrëveshje për funksionalizim të Spitalit të Përgjithshëm në Podujevë. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje të bashkëpunimit është ndërtimi dhe funksionalizimi i plotë i Spitalit të Përgjithshëm në Komunën e Podujevës.

Marrëveshja parasheh që Komuna e Podujevës, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, ta sigurojë dhënie në shfrytëzim të parcelës dhe të objektit ekzistues ShSKUK-së për funksionalizim të Spitalit të Përgjithshëm të Podujevës. Po ashtu, Komuna e Podujevës merr përsipër rrënimin e aneksit të objektit ekzistues shëndetësor në hapësirën përkatëse ku do të



planifikohet ndërtimi i aneks-objektit të ri të destinuar për nevojat e Spitalit të Përgjithshëm të Podujevës. Në anën tjetër, ShSKUK merr përsipër të gjitha obligimet për Spitalin e Përgjithshëm të Podujevës, që dalin nga statuti i ShSKUK-së për njësitë përbërëse të saj (Spitalet e Përgjithshme). Në marrëveshje theksohet se ShSKUK merr përsipër ndërtimin e aneksobjektit të ri

dhe përshtatjen me objektin ekzistues për nevojat e Spitalit të Përgjithshëm në Podujevë. ShSKUK-ja obligohet ta bëjë furnizimin me pajisjet e nevojshme mjekësore në kuadër të reparteve për Spitalin e Përgjithshëm në Podujevë e, po ashtu, merr përsipër rekrutimin e stafit shëndetësor dhe administrativ për nevojat e Spitalit të Përgjithshëm në Podujevë.

## Komuna e Dragashit ka filluar furnizimin me tekste shkollore për nxënësit

DRAGASH, 23 GUSHT (ER) - Në prag të fillimit të vitit të ri shkollor, Komuna e Dragashit, në bashkëpunim me MASHT-in, ka filluar furnizimin me tekste shkollore falas për të gjithë nxënësit e kësaj komune. Në

njoftimin e kësaj komune theksohet se investimi të fëmijët është investim në të ardhmen e vendit. "Investimi të fëmijët është investim tek e ardhmja e vendit tonë. Edhe pak ditë na kanë mbetur nga fillimi i vitit të ri

shkollor, DKA në bashkëpunim me MASHT-in kanë filluar furnizimin me tekste shkollore falas për të gjithë nxënësit në Komunën e Dragashit. Suksese të dashur nxënës!", është thënë në njoftimin e Komunës së Dragashit.



Me rastin e njëvjetorit të vdekjes së Adem Demaçit, 26 korrik 2018 (25)

# ADEM DEMAÇI, HERO I KOSOVËS DHE NDERI I KOMBIT

- Përshtypjet në "librin e zisë"



Përgatiti Selatin  
NOVOSELLA

Lavdia dhe respekti do t'ju përcjellë çdo herë, heroi im dhe i kombit tonë!

31 korrik 2018,  
Nasim Haradinaj

U nda nga ne Adem Demaçi, hero i popullit, simbol i rezistencës dhe i luftës çlirimtare, krenaria e kombit shqiptar! Të qoftë lavdi, Bacë!

31 korrik 2018,  
Mehmet Rukiqi

Faleminderit institucioni ynë moral e kombëtar, Baca Adem Demaçi! Edhe fjalët më të spikatura do të ishin të pafuqishme për të përshkruar madhështinë e figurës dhe veprës tënde! Krenar që jetuam në epokën tënde! Lavdi!

31 korrik 2018,  
Rigon Fazliu, Prekaz

Me respekt për atdhetarin e madh, Adem Demaçin! Lavdi!

31 korrik 2018,  
Roland Ruçi, Tiranë

Respekt për kolosin e atdheut, Bacën Adem Demaçi!

31 korrik 2018,  
Juli Agolli

Jeta e Tij ishte shembull që inspiron, kurse trashëgimia e tij është lëvizje e gjallë! Nga liria në burg dhe anasjelltas, nga politika paqësore në UÇK dhe anasjelltas, Baca Adem na priu si askush tjetër, si asnjëherë tjetër!

31 korrik 2018,  
(emri i palexueshëm) Kurti

Adem Demaçi ia kushtoi një jetë të tërë atdheut! Lavdi jetës dhe veprës së Bacës!

31 korrik 2018,  
Familja e Idriz Ajet Gashit nga fshati Petreshticë

Rruga e mbarë Bacë! Të fala atyre që e meritojnë!

31 korrik 2018,  
(nënshkrimi i palexueshëm)

100 vjet nuk lindin patriot si Baca Adem! Lavdi Bacë!

31 korrik 2018,  
Xh. Hajdari

Të lumtë na që të patëm, baca Adem! Lavdi të qoftë për jetë!

31 korrik 2018,  
Ilmije Prekupi, Lipjan

Bacë, ti ke ditur si të jetosh, të jetosh në të gjitha jetët, që do të kenë shqiptarët!

31 korrik 2018,  
Shefkije Islamaj

Baca Adem,  
Je mes nesh dhe do të jesh përgjithmonë me zërin tënd trimëruës dhe qortues, me guximin e njeriut të pamposhtur...

31 korrik 2018,  
Hysen Matoshi

Baca Adem mbetet flamur, betim për brezat që do të vijnë! Lavdi jetës dhe veprës se tij për bashkues kombëtare!

31 korrik 2018,  
Tafil Grajçevci

I nderuari, baca Adem,  
Jemi krenar që të patëm, që sado pak ishim bashkë, në rrugëtimin

tonë drejt lirisë! Lavdi të qoftë Bacë!

31 korrik 2018,  
Halil Çadraku

Të qoftë i lehtë dheu i Kosovës dhe më i merituari djalë i sajë, Baca Adem Jashari! Mbetë i pamposhtur siç ishte gjithë jetën! Lavdi!

31 korrik 2018,  
Prof. Ajmane Dhomi

Gjithmonë në jetë, jo vetëm do t'i ruaj, por edhe do të përcijem t'i përcjell tutje fjalët Tuaja: "Bacë, kur njeriu zgjohet nga gjumi në mëngjes duhet të mendoj se është njeriu më i rëndësishëm në mesin e popullit të vet dhe jo vetëm kaq, por gjatë gjithë ditës duhet të sillet e të punojë sikur krejt fati i popullit dhe atdheut të tij, varët prej tij dhe në fund, para se të shkoj në shtrat, t'ia kushtojë pesë (5) minuta kohë, të përgjigjet në pyetjen: Çfarë bëra sot për popullin tim, për atdheun tim?" Gjithmonë me respekt para emrit dhe veprës Tuaj!

31 korrik 2018,  
Ibish Neziri "Kërlezha"

Dua të besoj, se Baca Adem, edhe më tutje do të shërbej si



personalitet i orientimit tonë! me respekt e nderime të përjetshme!

31 korrik 2018,  
Faik Rracaj

Fjalët janë shumë të zbehta për të shprehur një mendim për veprën dhe kontributin tënd madhor, o më i madhi i kombit! Pusho i qetë se çdo gjë që pate e dhe për Kombin! Vepra jote titanike është udhërrëfyese për ne! Lavdi!

31 korrik 2018,  
R. Sadiku

Gëzimi më i madh për mua ka qenë lirimi yt nga burgu në vitin 1990. Tërë Kosova ka qenë në vizitë!

31 korrik 2018,  
Agim Jashari

Pusho i qetë simboli i qëndresës kombëtare dhe krenaria e shqiptarisë!

31 korrik 2018,  
(nënshkrimi i palexueshëm)

Burrë i fjalës, i luftës për Kosovën! Do të mbetesh përherë i gjallë për çdo atdhetar të Kosovës mëmë!

31 korrik 2018,  
(nënshkrimi i palexueshëm)

Baca ishte dhe mbetet shembëlltë e përkushtimit vetëmohues, çfarë nuk ishte parë gjatë në historinë e rezistencës paqësore, për liri!

31 korrik 2018,  
(nënshkrimi i palexueshëm)

Baca Adem do rroj çdo herë, në saje të veprës së tij atdhetare dhe sakrificës për lirinë e Shqipërisë!

31 korrik 2018,  
Blerim Grejçevci

Do të duhet kohë për të lindur edhe një njeri i tillë, si Baca Adem Demaçi!  
Lavdi i qoftë përjetë!

31 korrik 2018,  
Sylejman Berisha

Lavdi, Bacë!  
Iu faleminderit për kontributin tuaj për çështjen kombëtare, për një Kosovë të pavarur! Me respekt nga daja i Fadil Vatës, Azem Xhema

31 korrik 2018,  
Azem Xhema

Na nderove, na frymëzove, na bëre ta kuptojmë më mirë çështjen e çlirimit kombëtar! Luftëtar i paqes, por edhe i luftës! Të qoftë lavdi!

31 korrik 2018,  
(nënshkrimi i palexueshëm)

I përhershëm qoftë kujtimi për ju!

31 korrik 2018,  
(nënshkrimi i palexueshëm)

Të nderon Shoqata e të Burgosurve Politik të Klinës!

31 korrik 2018,  
(emri i palexueshëm) Krasniqi

Respekt për babanë e rezistencës së popullit shqiptar, bacën Adem!

31 korrik 2018,  
Arbër Haziri

Respekt për Mandelën e Kosovës! Lavdi jetës dhe veprës së Bacës Adem!


31 korrik 2018,  
Malësore Gashi

Veprat Tuaja janë vlera që do të komunikojnë gjatë me brezat e ardhshëm! Ato do të jenë udhërrëfim për brezin e ri të Kosovës!

31 korrik 2018,  
(nënshkrimi i palexueshëm)

Ke qenë njeri i veçantë, i cili do të mbetet në historinë e re të pasluftës së Dytë Botërore të Kosovës, si një nga figurat qendrore të saj!

31 korrik 2018,  
R. K



Faksimil i përshtypjes të Ismet Hajrullahut,  
mik i familjes Demaçi

(Vazhdon në numrin e ardhshëm)

# Pakti Hitler - Stalin

## 80 vjet më parë

Pakti Hitler - Stalin rezistoi gati dy vjet.

Në qershor 1941, kur Hitleri vuri nën kontroll gjysmën e Evropës Perëndimore, ai ndihej mjaft i fortë dhe sulmoi edhe partnerët e aleancës. Ky ishte një mbivlerësim i vetes që do të ishte vendimtar për zhvillimet e mëtejshme

**BERLIN, 23 GUSHT** - Ishte një kalkulim cinik. E kjo llogari në fillim ia vlejti për të dyja palët. Për planin e tij për të sulmuar Poloninë, Hitleri siguroi neutralitetin e Bashkimit Sovjetik. Meqenëse fuqitë garantuese të Polonisë, Britania e Madhe dhe Franca, do të viheshin në lëvizje prej këtij plani, ai përkohësisht e shmangu luftën në dy fronte. Përveç kësaj, me një marrëveshje tregtare të nënshkruar njëkohësisht të dy diktatorët ranë dakord për shkëmbimin e furnizimeve - lëndë të para sovjetike kundrejt makinerive gjermane.

Në këtë mënyrë Hitleri donte t'i bënte ballë efektit të një bllokade të mundshme detare të britanikëve, që në Luftën e Parë Botërore ndikoi në humbjen e Gjermanisë. Stalini nga ana e tij besonte, se Rajhu Gjerman nuk do të përzihej në një luftë të gjatë me fuqitë perëndimore. Në afat të gjatë ai e konsideronte të pashmangshme një luftë kundër Rajhut Gjerman dhe donte ta shfrytëzonte këtë periudhë për armatime të mëtejshme.

Ajo që ishte vendimtare nuk ishte përfshirë në marrëveshjen zyrtare, por në një protokoll sekret shtesë: Ajo i ndante në zona influence vendet mes Rajhut Gjerman dhe Bashkimit Sovjetik në rast të një "rikompozimi territorial-politik". Kësisoj, p. sh., Estonia, Letoni, pjesa lindore e Polonisë dhe Besarabia rumune ishin përcaktuar si "sfera të influencës" së Bashkimit Sovjetik, ndërsa pjesa perëndimore e Polonisë nën influencën e Rajhut Gjerman.

### Një kalvar i pafund

Më 1 shtator 1939 Vermahti



© picture alliance/AP/Heritage Images/Ann Ronan Pictures

gjerman sulmoi Poloninë. Dy javë më pas Ushtria e Kuqe marshoi në Poloni dhe pushtoi njëra pas tjetrës territoret e përcaktuara në sferën e influencës sovjetike. Ndarja e Evropës Lindore u realizua në dy javët e para të Luftës së Dytë Botërore që po niste. Ushtarakët gjermanë dhe ata sovjetikë, shërbimet sekrete dhe nëpunësit e administratës bashkëpunonin ngushtë mes tyre.

Polonia u zhdruk sërish nga harta politike. Shtetet baltike, që po ashtu si Polonia e fituan pavarësinë e tyre pas Luftës së Parë Botërore më 1919, u shndërruan në republika sovjetike. Besarabia rumune iu aneksua Republikës Sovjetike të Ukrainës. Kësisoj Rumania praktikisht mbeti "nën kontrollin e Gjermanisë naziste", shpjegon historiani rumun Cosmin Popa. Për njerëzit në të dyja anët e vijës ndarëse nisi një kalvar vuajtjesh të pafundme: Hitleri zbatonte në hapësirën e tij dhe në territoret e pushtuara ideologjinë raciste duke vrarë miliona njerëz, ndërsa në pjesën sovjetike u dëbuan pjesë të mëdha të popullsisë dhe shumë të afërm të elitave të vjetra u vranë ose u deportuan në kampet e punës së detyruar.

Pakti Hitler-Stalin rezistoi gati dy vjet. Në qershor 1941, kur Hitleri vuri nën kontroll gjysmën e Evropës Perëndimore, ai ndihej mjaft i fortë dhe sulmoi edhe partnerët e aleancës. Ky ishte një mbivlerësim i vetes që do të ishte vendimtar për zhvillimet e mëtejshme. Qysh në dimrin që

pasoi në aspektin ushtarak situata mori kthesë. Por pavarësisht për popujt e "sferave të influencës" kjo nënkuptonte edhe më shumë vite lufte përmes mjerimit, dëbimeve dhe miliona vdekjeve.

### Trauma mbetet

Trauma e bashkëpunimit gjermano-rus mbi kurrizin e të tjerëve është e pranishme në vendet e prekura. Në Poloni pakti Hitler-Stalin edhe sot e kësaj dite konsiderohet si një shembull i marrëveshjeve sekrete të dy fqinjëve të mëdhenj në disavantazh të saj. Në vitin 2006 ish-ministri i Jashtëm i Polonisë, Radosław Sikorski, linjën gazsjellëse Nord-Stream e krahasoi me paktin Hitler-Stalin-Pakt, gjë që shkaktoi indinjatë të të dyja palët.

Në shkrimin e historisë polake ky pakt konsiderohet si "ndarja e katërt e vendit - një referim ndaj tri ndarjeve në shekullin e 18-të kur Polonia u nda prej Ruisë, Prusisë dhe Austrisë dhe për më shumë se një shekull u fshi nga harta.

Në Luftën e Dytë Botërore marshimi sovjetik u shoqërua edhe me arrestimin e gati 22.000 oficerëve dhe policëve polakë, të cilët në pranverën 1940 u ekzekutuan prej shërbimit sekret sovjetik NKVD në Katyn dhe vende të tjera duke u qëlluar me plumb në qafë.

Edhe për Rumaninë pasojat janë ende sot të mëdha, thotë historiani Popa. Ekzistenca e Republikës së Moldavisë është pasojë direkte e paktit. "Ai

s'ishte gjë tjetër veçse shprehje e totalitarizmit të aplikuar në politikën e jashtme. Ishte një pretendim i qartë pushteti i dy totalitarizmave, komunist dhe atij nacionalsocialist", tha ai.

### Stalini rehabilitohet në Rusi

Pakti pati pasoja përtej luftës: Meqenëse BRSS bënte pjesë ndër fuqitë fituese, fuqitë perëndimore nuk mundën ta ndalojnë, "që territoret, që kishte marrë Bashkimi Sovjetik përmes paktit Hitler-Stalin, në fund të Luftës së Dytë Botërore të mbeteshin nën BRSS", thotë historiani Jörg Ganzenmüller. Vetëm në fillim të viteve 1990-të shtetet baltike rifituan pavarësinë e tyre.

Pakti Hitler-Stalin pas luftës për shumë vite u mbulua prej harresës. Në Lindje gjatë Luftës së Ftohtë ai u tabuizua. Në Republikën Federale të Gjermanisë ai nuk luante më asnjë rol në zbardhjen e historisë së pasluftës. Vetëm pas kthesës më 1989 në Evropë ai u risoll në vëmendje në diskutimin publik.

Sidoqoftë plagët nuk u shëruan, përkundrazi. Para dhjetë vjetësh, me rastin e 70-vjetorit, presidenti i Ruisë Vladimir Putin në një letër drejtuar polakëve e cilësoi paktin si të pamoralshëm. Por ky deklaram u zhvleftësua po prej tij. Pak muaj më vonë pas aneksimit rus të Krimesë në Ukrainë, Putini e mbrojti paktin, duke argumentuar se nga këndvështrimi i asaj kohe ai ishte i domosdoshëm.

Në ceremonitë përkujtimore sivjet me rastin e 80-vjetorit të fillimit të Luftës së Dytë Botërore, Putini nuk do të jetë i pranishëm. Në Rusinë e sotme edhe Josef Stalin është rehabilituar. Në një sondazh gjatë këtij viti 70 për qind e rusëve shprehen pozitivisht për rolin e Stalinit për vendin e tyre.

### Frikë të reja dhe të vjetra

Kësisoj në Poloni dhe në shtetet baltike sërish shtohet frika, se ato mund të bien përsëri viktimë e një politike, përmes së cilës Gjermania dhe Rusia mund të bien dakord mbi kurrizin e këtyre vendeve. Ndërtimi i linjës direkte gazsjellëse Nord Stream 2 nga Rusia përmes Detit Baltik në Gjermani duke iu shmangur vendeve të transitit është kthyer në një simbol të kësaj frike. Në këtë grindje Polonia së fundi ka angazhuar në anën e vet SHBA-në, sepse lidhur me këtë çështje ajo e ndjen se fqinjët nuk e vlerësojnë me seriozitet.

"Analogji historike nuk mund të bësh", thotë studiuesi Ganzenmüller lidhur me këtë. Frika është e ekzagjeruar: "Polonia dhe shtetet baltike janë shumë më pranë Gjermanisë sesa Rusia". Për këtë flet edhe anëtarësia e përbashkët në BE dhe në NATO. "Megjithatë politika e jashtme gjermane ndoshta ndjek me pakujdesi interesat e saj në politikën e jashtme, duke mos i marrë në konsideratë këto frikë dhe me këtë ngjall irritime", tha ai. Ndaj historiani këshillon për Qeverinë gjermane, që t'i marrë më fort parasysh këto shqetësime që burojnë nga e kaluara. (dw).



Shpall konkurs për pranimin e fëmijëve të moshave të ndryshme (0,9 - 6 vjeç)

Aplikimi për regjistrim të fëmijëve fillon nga data:  
**10.08.2019 deri 30.08.2019**

Për çdo informatë shtesë mund të drejtoheni përmes telefonit 045 714 713.



E rrallë

# Karvani i pafund i gamileve në shkretëtirë

Një nga vendet e preferuara për pushuesit që vendosin të bëjnë turizëm brenda vendit të tyre, në Kinë, është qyteti i Dunhuangut, ku vizitorët mbajnë radhë për të udhëtuar me gamile nëpër shkretëtirë. Kjo foto e realizuar këtë javë shfaq një karvan që duket i



pafund, e që tregon edhe një herë se sa ndikim ka numri i madh i popullsisë në Kinë.

FOTO E DITES



Kryeministri i Britanisë, Boris Johnson, gjatë takimit me presidentin Emmanuel Macron në Pallatin Elysee në Paris, vendos këmbën mbi tavolinën e pritjes. /AP/

E jashtëzakonshme

# Kapet peshku me dy gojë

Fotoja e një peshku me dy gojë u bë menjëherë virale në rrjetet sociale, pasi u postua nga një grua në ShBA, e cila e kishte kapur këtë peshk në Nju Jork. Gruaja, e quajtur Debi Geddes, ka theksuar për "Fox News" se peshku ishte i shëndetshëm dhe i fortë, edhe pse kishte dy gojë. Peshku u kap te Liqeni Champlain dhe disa thonë se peshku mund të ketë pësuar anom-



ali edhe prej mbetjeve të shumta që hidhen në atë liqen nga Kanadaja dhe Vermonti.

## BARSOLETA E DITËS



Gruaja, pas një grindje të ashpër me burrin:  
- O Zot, të lutem merrem!  
- Jo, jo, s'të merr, se ai s'është budalla si unë.




### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

#### Çdo ditë në ora 15:30 The Angry Birds Movie 2 (3D)

Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 39 min  
Rolet: Jason Sudeikis, Josh Gad, Leslie Jones, Bill Hader, Rachel Bloom, Danny McBride, Peter Dinklage, Nicki Minaj, etj.

Regjia: Thurop Van Orman



#### Në ora 17:30

### GOOD BOYS

Aventurë/Komedi; 1 orë 29 min

Rolet: Jacob Tremblay, Keith L. Williams, Brady Noon, Molly Gordon, Lil Rel Howery, Will Forte, etj.

Regjia: Gene Stupnitsky




#### Çdo ditë në ora 19:15

### "HOBBS & SHAW"

Aksion/Aventurë/Triller; 2 orë 15 min

Rolet: Dwayne Johnson, Jason Statham, Idris Elba, Vanessa Kirby, Helen Mirren, etj.

Regjia: David Leitch




#### Çdo natë në ora 21:30

### ONCE UPON A TIME IN HOLLYWOOD

Komedi/Dramë; 2 orë 41 min

Rolet: Leonardo DiCaprio, Brad Pitt, Margot Robbie, Al Pacino, etj.

Regjia: Quentin Tarantino



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), fb: Kino ABC.




#### DASHI

Një shef skrupoloz ose një i afërm i bezdisshëm sot s'po ju lënë të qetë. Në çdo moment do të jepni informacione se çfarë jeni duke bërë.



#### DEMI

Megjithëse në mëngjes keni pasur mjaft surpriza akoma nuk ka përfunduar efekti i tyre. Disa të mira disa më pak, do të vazhdoni të keni të reja.



#### BINJAKËT

Gjithkush që mbush ditën tuaj sot do të merret me punët e veta personale duke ju lënë të qetë të mbyllni gjëra që ju ka kaluar afati.



#### GAFORRJA

Jeni i gatshëm të jepni kontributin tuaj për të ndryshuar disa mendësi në familjen tuaj që janë disi të prapambetura. Do të kërkonti mbështetje.



#### LUANI

Jeni goxha të ngarkuar në punë sot dhe nuk do të mund të bëni dot asgjë pa miratimin e një kolegut tuaj. Në debat e sipër do të tejkaloni pak limitet.



#### VIrgjresha

Dita sot do të fillojë shumë vullshëm dhe ju nuk do të keni kohë të merrni frymë nga impenjimet e shumta.



#### PESHORJA

Me miqtë dhe të afërmit koha kalon shkëlqyeshëm por sapo afrohet dikush i panjohur në orbitën tuaj bëheni mjaft protektivë.



#### AKREPI

Po mbani ekuilibër të brendshëm me ata persona që e shikoni që kanë gjithmonë diçka për të thënë kundër jush. Nuk do të arrijnë t'ju prishin ditën.



#### SHIGJETARI

Financat tuaja paraqiten shumë mirë këtë periudhë dhe gjithçka ka të bëjë me kontrata dhe marrëveshje do të jetë në favorin tuaj.



#### BRICJAPI

Hëna në shenjë ju ndihmon sot të mos afektoheni shumë nga nostalgjia dhe nga probleme të vogla që mund t'ju prishin punë.



#### UJORI


Sot jeni të pushuar nga dashuria dhe kësaj here e keni lëshuar totalisht veten të përjetoni pasionin dhe dëshirën me sy mbyllur.



#### PESHQIT

Sot jeni nostalgjikë dhe po mendoni veç për dashurinë. Një ndjenjë e mirë që ju bën mjaft të përkushtuar ndaj njerëzve.

## Dwayne Johnson sërish kryeson listën e aktorëve më të paguar



**D**wayne Johnson ishte aktori më i paguar i vitit të kaluar, sipas renditjes vjetore më të fundit nga "Forbes". Ai u ngjit nga numri dy vitin e kaluar, me gjithë fitimet e tij prej 89.4 milionë dollarësh. Në të vërtetë janë më pak se 119 milionë dollarë sa bëri

në vitin 2018. Aktori numër një i vitit të kaluar George Clooney ka rënë nga top dhjetëshja për shkak se fitimet e tij të larta në listën e vitit 2018 kishin rënë pas shitjes së kompanisë së tij "Tequila", në një marrëveshje me vlerë 1 miliard dollarë.

## Martohen Justin Bieber dhe Hailey Baldwin, kjo është ftesa e dasmës



**K**ëngëtari Justin Bieber dhe modeluesja Hailey Baldwin do të martohen edhe një herë. Çifti i njohur do të kenë një dasmë të dytë më 30 shtator të këtij viti. Këtë e ka bërë me dije për "TMZ" me anë të një artikulli ku publikoi ftesat e dasmës, të cilat janë interesante. Këto ftesa të dasmës përmbajnë ilustrime ku mendohet se është fytyra e modelueses dhe e këngëtarit.



## Ashley Graham për herë të parë del në publik gjatë shtatzënisë

**S**upermodeluesja e njohur Ashley Graham para disa dite ka bërë me dije për adhuruesit e saj se është shtatzënë. Ajo ka postuar disa fotografi dhe video


në rrjetin social "Instagram" duke thënë se pret fëmijën e parë. Paparacët e fotografuan aktoren teksa kthehej në shtëpinë e vet në Los Anxelos.

## Gigi Hadidi e zyrtarizon lidhjen me Tyler Cameron



**M**odeluesja e njohur Gigi Hadid është në lidhje të dashurisë me Tyler Cameron. Sipas "Hollywood Life", kjo lidhje është zyrtarizuar pasi Cameron

u takua me pjesën tjetër të familjes Hadid. Këtë e ka bërë me dije një burim i afërt i çiftit për "Hollywood Life", ku shtoi se ata ishin për ta vizituar fermën e familjes Hadid.



<b>Autor: GAZMEND MORINA</b>	MJET KOMUNIKIMI (shq.)	METAFORË E GJATË	SUPER MODELJA BRAZILIANE ADRIANA ....	PARA TË NËNTËS	KËNGA E POPULLARIZUAR QYTET NË SHQIPËRI
FILOZOF NË GREQINË E LASHTË (shq.)					
PARIA E SHOQËRISË (sh.shq.)					
FRIKË E MADHE					
					LLOJ DRURI
PËRFAQËSI DIPLOMATIKE MË E ULËT SE AMBASADA (hist.) FONI ALBA			AKTORJA ... FRIEL LLOJI I NJË PRODHIMI SIPAS FORMËS E MADHËSISË		
KËNGËTARJA RITA ...				DITMAR HAMAN SIPËR	
INICIATIVA					QYMEZ ELEMENT KIMIK (SE)

SUDOKU								
1			6		9			4
	8							1
	9	2	7		5			3
		4		2	6			5
6								9
		7	8				4	
	4		3		1	5	8	
5								9
	7		5	4				3

<b>EPOKA E RE</b>	ISH KËNGËTARI AMERIKAN NË FOTO	TUPAN	SHTET NË EVROPE	SCREEN ACTORS GUILD	ZANORE	ZANORE KËNGËTARJA ... ISTREFI	OSMAN BAJRAMI KUDRET ISAI		LLOJ PIJE E NXEHTË E ORIENTALE (shq.) SHITRESË										
PUBLICISTI SHQIPTAR ..... YPI							DISIPLINË SPORTIVE KA A DEM I PATREDHUR (shq.)						NAIM ISMAJLI SHASTISEM						KRYEQYTETI I JORDANISË
NJOLLA					PEZMATIM I VESHIT REGJISORI ... SOPI				ISH FUTBOLLISTI SHEARER (orgj.) LUMË NË AFRIKË				RESHAT ARBANA SHOSHITET						
E NDRYRË, BANALE AKTROJA & MODELJA JOVOVICH							KUJDES I VEÇANTË QË TREGOJMË PËR DIKË ISMET PEJA												
				PJESËMARRJA NË NJË GARË DHËMBOR															ZANORE SHKENCA QË MERRRET ME KRIJIMIN E MALEVE
DIÇKA LËNDORE KONKRETE E BOTËS JO TË GJALLË; GJË (shq.)						THIRRJA QË I BËHET MASËS AI ME TË CILIN QUHEMI													ELEMENT KIMIK (NT) "RIADI"
BASHKËT.		GJOJA, KINSE GODINA MBI LUMË					BASHKËT. NDALIMI		GRYKA E VULLKANIT NËNË (turq.)										
MBRON DIÇKA NGA DIKUSH					FUTBOLLISTI SULLEY (MILAN) SHKEL E SHKO, RRËMUJË								FUTBOLLISTI SAMUEL ... LLOJ PAPANAGALLI						VETI E ATLJ QË ËSHTË TRIM
ISMET RAMUSHI			TANTAL, REOMIR BIMË QË PËRDORET PËR TË MBULUAR ÇATITË (shq.)				LETRARI MEHMETI (shq.) KËNGËTARJA NJOMZA						AZEM MAKSUTAJ LUMË NË KOSOVË					DY BASHKËTINGËLLORE PAJTUESHMËRI (krah.)	
LËNDË KRISTALORE SHUMË E ËMBËL									KUNDËRSHTAR I BOLSHEVIZMIT RUS ZANORE					"E" në mes të dy "R" GROSETO, ATALANTA					
BASHKËT.		ALUMIN, AMPËR ARRATISUR				KËNGËTARJA ... FARA ELIZABETH BANKS			STUHIA E FORTË ME ERË DHE SHI ZANORE										
"LL" pas dy "I"				USHQIM QË SHTROHET E HAHEG GJATË PIJES NATRIUM, TON					"EPOKA ... " KËNGËTARJA PERUANE ... SUMAK					SHKRIMTARI SHKRELI ISH AKTORJA AMERIKANE GARDNER					
<b>EPOKA E RE</b>	LLOJ BIME NARKOTIKE (shq.) DY BASHKËTINGËLLORE								KRYEPROKURORJA E SHQIPËRISË ... RAMA ARTIOLA TOSKA					LEJE PËR TË SHKUAR NGA ODA EDITA SOPJANI					
BIXHOZ						KËNGËTARJA VALENTINA BASHKËT.													ANA RUSO ISLANDA
EMËR YNI DJALI (shq.)							BANORI I ATIKËS												ZANORE

ZGJIDHJA E FJALËKRYQIT: TALESI, ELIAT, LEMERI, LEGATA, FO, ANA, ORA, DM, NISMA, KOTEC, I, OB, SALEPI, EDISON, KRIBET, NI, LARA, OTIT, ALAN, RA, VULGARË, INTERESIM, MILLA, GARIMI, NIMI, A, SENDI, APELLI, NITON, P, DEMEK, N, KRATERI, RUANI, MUNTARI, ETO, IR, TAR, DINI, AM, GJT, SAKARINA, ESER, RER, LL, ALA, ELI, URAQANI, ILLI, MEZE, ERE, AZEM, KANABISI, INA, IZE, KUMAR, RAMA, I VE, AR, DRITANI, ATIKASI, I. ZGJIDHJA E SUDOKUT: KOJONA I: 135 689 742; KII: 768 432 951; KIII: 492 715 638; KIV: 314 926 875; KV: 658 147 329; KVI: 927 853 416; KVII: 249 361 587; KVIII: 563 278 194; KIX: 871 594 263.



Fragmente intervistash të Umberto Ekos

# Jam i lumtur që i mashtrova ata që vdiqën para meje

## Jeni rritur në Alessandria. Çfarë qyteti është ai?

Alessandria është një qytet që nuk lëviz, skeptik, pa entuziazëm. Është edhe qyteti që kishte të vetmin papë jonepotist, i cili kurrë s'kishte një geto hebre dhe i cili kurrë nuk spekuloi rreth Shën Françeskut. Një qytet, pra, pa heronj dhe pa mite, por që nuk ka vvarë askënd asnjëherë për t'i pasur ato.

## Familja juaj?

Babai im ishte kontabilist, kurse babai i tij një shtypës librash. Babai im ishte i pari nga trembëdhjetë fëmijët që kishin prindërit e tij. Gjyshi im kishte shumë ndikim në jetën time, megjithëse nuk e vizitoja shpesh. Ai vdiq kur isha gjashtë vjeç. Ai ishte jashtëzakonisht kurioz dhe lexonte shumë libra. Kur doli në pension filloi t'i rilidhte librat. Por, ai kishte edhe shumë prej tyre të parilidhura në apartamentin e vet - botime të vjetra, të mrekullueshme të romaneve të njohura nga Gautier dhe Dumas. Këta ishin librat e parë që kam parë. Kur vdiq në vitin 1938, shumë pronarë të këtyre librave të parilidhura nuk i kërkuan përsëri dhe familjarët i vunë në një kuti. Pothuajse rastësisht ajo kuti përfundoi në bodrumin e shtëpisë sime. Nganjëherë më urdhëronin të zbrisja në bodrum për të marrë qymyr ose një shishe verë dhe një ditë nga ato hapa kutinë dhe zbulova thesarin e librave. Për fat të keq, do t'i kisha humbur të gjitha, por me kalimin e kohës i bleva.

## Kur vendoset çfarë do të donit të bëheshit kur të rriteshit?

Deri në gjashtë vjet dëshiroja të bëhesha tramvajnist. Pastaj në moshën tetë vjeçe fillova të lexoja Salgarin dhe librat e gjyshes. Kështu, pra, fillova të shkruaja tregime për një shtëpi botuese krejtësisht personale.

## Si lindi "Emri i trëndafilin"?

Romani ka lindur rastësisht. Kam marrë propozimin për të shkruar një histori policeske prej njëqind faqesh. E refuzova për shkak të mungesës së kohës. Më pastaj, duke u kthyer në shtëpi, fillova të mendoj për këtë ide që me siguri e pashë të vendosur në Mesjetë. Kam gjetur një traktat mbi helmët në duart e mia. Flitej për një nga ato që janë të afta për të kaluar nëpër lëkurë. Instinktivisht më erdhi në mendje një roman me pesëqind faqe.



## Si reagan kolegët e universitetit për suksesin tuaj? Po shkrimtarët?

Njëherë, do të doja të theksoja, vetëm pas romanit mora 38 gradë nderi (lauree ad honorem), kështu që, siç duket, kolegët e universitetit e kanë pritur mirë suksesin tim. Nëse ka ndonjë që nuk e ka pritë mirë suksesin tim, ata sigurisht se nuk janë studentë apo kolegë universiteti. Në Itali, për arsye të ndryshme, dikush tha: "Po ky deri dje ishte kamerier në një bar". Nuk ishte zili, thjesht nuk më pranonte i afërmi i shtëpisë. Sepse këta të shtëpisë e dinë një pafundësi të aktiviteteve të mia "zullumqare", për shembull, ditari i vogël e të tjera e tjera të ngjashme, ndërsa jashtë shtëpisë (jashtë Italisë, v. i.) unë atje shfaqem vetëm si autor i librave seriozë. Pastaj është edhe një tjetër karakteristikë italiane. Nëse në Shtetet e Bashkuara Philip Roth shet shumë libra, kjo nuk e zvogëlon imazhin që bëjnë kritikët. Unë mund t'ju tregoj - por ju duhet t'i merrni disa dosje - të paktën dy zotërinj shumë të njohur të cilët kanë shkruar mirë sapo kam botuar librin "Emri i trëndafilin". Dhe, më pas, kur libri arriti 200 mijë kopje, ata shkruan të kundërtën. Nëse ai kishte mbetur brenda 5 000 kopjeve do të ishte një kryevepër.

## Kanë kaluar tetë vjet mes këtij debutimi dhe romanit të dytë, pse?

Për "Emrin e trëndafilin" kisha mijëra dokumente në duar dhe

m'u deshën vetëm dy vjet për ta shkruar, ndërsa hulumtimet dhe shkrimi i "Lavjerrësi i Fukoiti" zgjati tetë vjet. Edhe pse s'i tregoja askujt se çfarë po bëja, sot e kam të qartë që kam jetuar në një botë krejtësisht timen për gati një dekadë.

## Po kompjuteri, a e ka ndryshuar mënyrën e të shkruarit tuaj?

Askush s'mund të parashikonte qartë se çfarë do të ndodhte. Por dokumenti i parë i Belbos (Belbo, një ndër personazhet e një prej librave të tij) shpjegon se si kompjuteri do ta kishte ndryshuar marrëdhënien mes mendimit dhe shkrimit, me dorën që me bindje ndjek ritmin e imagjinatës tënde, pa u brengosur shumë, sepse më vonë ju keni mundësinë e korrigjimit, pastrimit, kontrollit të tepërt, shpesh edhe të rishkrimit. Kjo bën një dallim të madh midis atyre që shkruajnë sot dhe atyre që janë gdhendur në pllakat e argjilës. Qysh atëherë ishte e qartë.

## Pa kompjuter s'do të kishte internet, dhe prapë jeni i një ideje tjetër?

Interneti është si një bibliotekë e pafundme, pa filtrim. Virtytet e bibliotekave, si enciklopedi, nuk janë vetëm për të ruajtur kujtime, por për të hedhur atë që nuk është e nevojshme në një kulturë. Nëse nuk do të hidhnim asgjë, do të ishim si "Funes el memorioso", i një tregimi nga Jorge Luis Borges. Ky personazh kujtonte gjithçka: ai ishte një njeri me kujtesë të plotë, i paaftë

për të arsyetuar, sepse nuk ishte në gjendje të filtronte. Interneti është si Funes: përmban gjithçka, të vërtetën dhe të rrejshmen, e gjithë kjo është një rrezik serioz, posaçërisht për të rinjtë.

## A ka mbizotëruar fryma e tij apokaliptike?

Jo, jo tërësisht. Kur Gutenbergu shpiku shtypjen e tipit lëvizës, më të varfrit nuk u nisën menjëherë për të marrë një kopje të Biblës me 42 linja, por e lexuan atë një shekull më vonë. Dhe mos ta harrojmë Martin Lutheron. Pavarësisht prej analfabetizmit të madh, përkthimi i tij i Dhiatës së Re qarkullonte në të gjitha klasat shoqërore të Gjermanisë së shekullit të gjashtëmbëdhjetë. Ajo që na nevojitet është një rrjet (internet) Lutheron.

## Ndërkohë nuk ka asgjë që mund të bëhet?

Kultura është një ndërrim i vazhdueshëm midis fjalës së lirë dhe kritikës ndaj këtyre grupfjalësh. Ajo që po ndodh me uebin, nga ana tjetër, është se idolizon idealin e fjalës së plotë, pa asnjë kontroll nga të tjerët. Me dashtë të jem i keq - ose apokaliptik - mund të them se është triumfi i "fjalës për idiotin". Por kjo nuk është kulturë. Ose më mirë, idioti mund të flasë, madje dhe të ligjërojë në universitet për sa kohë që u mbetet mundësi të tjerëve të argumentojnë, ta sfidojnë, të paraqesin modele alternativash. Me këto forma të pseudopjesëmarrjes, nga ana tjetër, çdokush shpreh atë që i

vjen në mendje, ndonjëherë edhe duke u kënaqur me tonet dhe përmbajtjet fyese. Kështu, supozimi themelor i demokracisë, ose supozimi se jo gjithçka që thuhet është e mirë, rrezikon të bjerë. Ata që teorizojnë të kundërtën, duke mbrojtur thjesht shprehjen e fjalës si formë e vetme e shprehjes, në fakt kanë hequr dorë nga demokracia - pra, nga arsyet e kulturës demokratike - si kritikë e opinionëve.

## Cili është roli i një intelektual, atëherë?



Kur një intelektual flet për një parti politike ai nuk e bën fare punën e tij si intelektual. Ai e bën punën e tij si qytetar. Kur them që intelektualët duhet të heshtin, flas për intelektualin në kuptimin e krijuesit të mendimeve. Funkcioni i tyre është të reflektojë mbi atë që ka ndodhur, se çfarë mund të ndodhë. Ta zëmë që dikush është ekspert i sistemeve të sigurisë. Nëse është e nevojshme, ai duhet të shkruajë në sallat kinematografike nuk kanë sisteme të mjaftueshme të kontrollit kundër zjarrit. Pra, dhe në këtë mënyrë ushtron funksionin e tij kritik si intelektual. Në çastin që ai është në kinema dhe kinemaja merr zjarr, ai më nuk ka asgjë tjetër për të bërë aty, pos asaj që çdo person i ndjeshëm duhet të bëjë. Dhe nëse ai është më i vëmendshëm, si qytetar, ai do të jetë i pari që do ta kapë telefonin dhe do t'i thërrasë zjarrfikësit. Por, për ta pyetur veten në atë çast, ndërsa shtëpia digjet, për të nënshkruar një apel, është një formë e kotë e argëtimit.

## A ka ndonjë gjë për të cilën do t'ju vinte keq?

Ndoshta do të plakem i gëzueshëm sepse mendoj se pleqëria është diçka e bukur. Unë nuk i kuptoj shokët e mi që ankohen: jam i bindur se kam të njëjtën kujtesë çeliku si kur isha djalë i ri, edhe pse kaloj net në kërkim të librave me një kthesë të verdhë që kanë një kthesë të kuqe. Sigurisht se kam një përvojë të madhe. Dhe pastaj... jam i lumtur që mashtrova të gjithë të tjerët që vdiqën para meje.

*(Fragmente nga intervistat e Umberto Ekos dhënë mediave: The Paris Review, Corriere della Sera, l'Espresso, The New York Times, L'Unità, La Stampa, Internazionale, Wired, La Repubblica. Zgjedhi: Gi. Rizzo. Përktheu nga italishtja në shqip: L. Buçinca, për revistën "Akademia")*

# Makina e parë “Porsche type 64” e prodhuar në 1939, në ankand për 20 milionë dollarë



“Type 64” e vitit 1939, u quajt si makina e parë e Porsche, prototipi i parë që u pasua nga marka e famshme, dhe u nxor në ankand këtë të shtunë për 20 milionë dollarë, në Monterej,

Kaliforni. Por ankandi nuk u krye, për shkak se vetë kompania “Porsche” ndërhyri nëpërmjet zëdhënësit të “Muzeut Porsche”, dhe thanë se kjo makinë nuk

është në fakt “Porsche”. Ngatërresa erdhi prej bashkëpunimit që ka pasur Ferdinand Porsche, themeluesi i kompanisë, me markën “Volkswagen”.

Porsche dizajnoi makinën e parë popullore të Volkswagen-it, “Beetle”, modeli që mban rekord për jetëgjatësinë më të madhe në prodhim. Kur Ferry Porsche, djali i Ferdinand Porsche, shiti

makinën “Type 64”, në kontratë ishte shkruar “Volkswagen Sport”. Por zëdhënësi i muzeut, edhe pse tha se kjo makinë nuk është e tillë, ndonëse e pranoi që përfaqëson ADN-në e Porsche.



# Sheikët në Dubai, “thesari” që gjendet në varrezat e makinave



Bugatti, Porche, Rolls Royce, por edhe një Ferrari Enco që vlen 1 milion euro. Nuk është lista e ëndrrave e çdo dashamirësi, por fatkeqësisht ajo që mund të gjesh në

varrezat e makinave në Dubai. Janë rreth 3000 mijë makina luksoze që çdo vit gjenden të braktitura në rrugët e emiratit arab. Standardi i jetesës nuk justifikon

diçka të tillë, por ligjet e Dubait po. Sipas ligjit islamik në Emiratet e Bashkuara Arabe, vendasit por edhe të huajt rezidentë nuk mund të mos shlyejnë borxhet, sepse kjo

grykohet si aktivitet penal, edhe për afate të shkurtra. Mungesa e pagesës së kartës së kreditit, ose të qerasë, mund të të dërgojnë direkt në burg. Ashtu si

dhe kështu e makinës, sado luksoze ajo të jetë. Kështu që qindra makina lihen thjesht në mëshirë të fatit, dhe këto foto tregojnë mirë situatën.



# Kjo analizë zbulon me saktësi vdekjen e njerëzve

Një analizë gjaku mund të parashikojë nëse do të vdisni brenda 10 viteve të ardhshme, dhe shifra e frikshme e saktësisë është 83%.

Një ekip shkencëtarësh në Holandë zbuluan se duke u bërë matje 14 substancave metabolike në gjak, ata mund të parashikojnë nëse një person mund të vdesë apo jo në 10 vitet e ardhshme.

Shkencëtarët morën të dhëna nga 44.168 persona, nga mosha 18 deri në 109 vjeç. Ata klasifikuan vdekjet e tyre dhe matjet e 226 substancave të ndryshme në gjak, për 17 vite.


Nga këta 44.168 persona, 5512 vdiqën brenda këtyre 17 viteve. Dhe nga 226 substancat në gjak, 14 prej tyre mund të parashikojnë nëse personi do të vdesë në 5 deri 10 vitet e ardhshme me një saktësi

prej 83%.

Një pjesë e mirë e këtyre substancave nuk janë aspak për t'u habitur, pasi janë tregues të sëmundjeve të zemrës, kancerit e diabetit. Të tjera janë po ashtu treguesit e kolesterolit të keq, acidet, albumina e të dhëna të tjera që lidhen me sëmundjet e mëlçisë. Por disa substanca janë risi, si acetoacetatet, të cilat s'ishin lidhur deri më sot me sëmundjet vdekjeprurëse.

Të dhënat janë shumë të rëndësishme për të manovruar kujdesin që duhet të ketë një pacient, e për të vendosur nëse ia vlen apo jo të bëhet një operim i rëndë.

Gjithsesi, të dhënat janë marrë vetëm nga banorë të Europës, dhe nuk është e thënë që mund të vlejnjë edhe për racat e tjera.



# Mes akullit dhe zjarrit, njihuni me jetën e pabesueshme të fisit të "egër" në Rusi

Për mijëra vite, nenetët kanë migruar me drerët e tyre në gadishullin Yamal në pjesën ruse të Arktikut.

Jeta e tyre ka vetëm dy elementë bazikë, akullin dhe zjarrin. Megjithatë, ata kanë ditur t'i përshatën më së miri terrenit të ashpër dhe sot mendohet se numri i tyre është mbi 44 000 individë.

I vetmi kontakt i detyruar me pjesën tjetër të Rusisë është kur femrat shtatzënë duhet të lindin, pasi me ligj duhet ta bëjnë këtë në një spital, ku merren me avion dhe dërgohen në zonat e banuara.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

# Humbja ndaj 'Niklit', e papranueshme për Ballkanin

Liridon Fetahaj e ka paralajmëruar Feronikelin se nuk do ta ketë aspak të lehtë përballjen me Ballkanin që synon rezultat pozitiv në Suharekë. "Jemi përgatitur maksimalisht dhe synimi i Ballkanit në këtë ndeshje është rezultati pozitiv. E respektojmë Feronikelin sepse ka kualitet dhe është kampion në fuqi, por ne luftojmë për tri pikët e plota dhe cilido lojtar që do të nisë nga fillimi do ta japë maksimumin", ka thënë Fetahaj

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 23 GUSHT - Skuadra e Ballkanit ka bërë të gjitha përgatitjet e duhura për të dalë e pamposhtur nga përballja me kampionen në fuqi të IPKO Superligës, Feronikelin. Këtë lajm e ka konfirmuar sulmuesi Liridon Fetahaj të premtën për "Epokën e re". Ndeshja në mes të Ballkanit dhe Feronikelit zhvillohet sot (e shtunë) nga ora 17:00, në kuadër të xhiros së dytë në elitën e futbollit të Kosovës. "Jemi përgatitur maksimalisht dhe synimi i Ballkanit në këtë ndeshje është rezultati pozitiv. E respektojmë Feronikelin sepse ka kualitet dhe është kampion në fuqi, por ne luftojmë për tri pikët e plota dhe cilido lojtar që do të nisë nga fillimi do ta japë maksimumin", ka thënë



Fetahaj, i cili në afatin kalimtar të verës është transferuar në Suharekë nga skuadra e Prishtinës, pasi nuk bënte pjesë në planet e trajnerit Mirel Josa.

Ballkani luajti baras, pa gola, 0-0, në ndeshjen e parë ndaj Dukagjinit në Klinë, kurse Feronikeli e mposhti bindshëm në Drenas, Drenicën (4-1). Synimi i kampionëve në fuqi është fitorja edhe në ndeshjen e dytë. Përparim Islami ka thënë për gazetë se Ballkani ka skuadër cilësore, por fitorja do t'i takojë Feronikelit. "Kampionatin e kemi filluar ashtu siç

e kemi parashikuar, kemi bërë një lojë mjaft të mirë dhe e kemi fituar ndeshjen me rezultat të thellë 4-1 ndaj Drenicës. Tash lojën e radhës e kemi me Ballkanin, një ekip mjaft i kompletuar, që ka bërë përforsime cilësore, po ashtu ka bërë ndryshime edhe në shtabin teknik. Loja do të jetë e vështirë, por ne do t'i qasemi lojës në mënyrën më serioze dhe në Suharekë udhëtojmë për tri pikë", ka thënë Islami. Sot (e shtunë) zhvillohet edhe ndeshja tjetër në mes të Ferizajt dhe Gjilanit, kurse dy ndeshjet e tjera zhvillohen nesër (e diel).

## IPKO SUPERLIGA

**Të shtunën takohen:**  
17:00 Ferizaj - Gjilani  
17:00 Ballkani - Feronikeli

**Të dielën takohen:**  
Drita - Flamurtari  
Vushtrria - Trepça '89

## LIGA E PARË

**Të shtunën takohen:**  
17:00 Ramiz Sadiku - Dardana

**Të dielën takohen:**  
17:00 2 Korriku - Vitia  
17:00 Onix - Vëllaznimi  
17:00 Drenasi - Arbëria  
17:00 Ulpiana - Istogu  
17:00 Besa - Vllaznia  
17:00 Trepça - Liria

## SHKURT

### Besa Famgas fillon mbrojtjen e titullit në Mitrovicë

Të premtën është tërhequr shorti për edicionin 2019\2020 të Superligës së Kosovës në hendboll (meshkujt). Kampionati i ri fillon në mes të muajit shtator, kurse ndeshjet e javës së parë luhen më 14 e 15 shtator. Kampioni aktual, Besa Famgas, e fillon mbrojtjen e titullit me ndeshjen ndaj Trepçës në Mitrovicë. Fituesi i Kupës, Kastrioti, në xhiron e parë e pret Vushtrrinë në Ferizaj. Tri ndeshjet e tjera të javës së parë janë: Drita - Prishtina, Vëllaznimi - Llapi dhe Prizreni - Drenica.

### Presidenti i Fenerbahçes: Ka vite që na ka munguar një sulmues si Muriqi

Vedat Muriqi ka debutuar me gol në një ndeshje zyrtare me klubin e ri të Fenerbahçes. Kjo e fundit në xhiron e parë të javës së Superligës së Turqisë triumfoi thellësisht me rezultat 5-0 kundër Gaziantepit. Kjo ka bërë të vlerësohet lart edhe paraqitja e reprezentuesit të Kosovës, i cili raportohet se ka marrë nota pozitive prej presidentit të klubit, Ali Koç. "Për një kohë të shkurtër Vedati është bërë ikonë e shumë fansave të rinj si dhe fëmijëve. Më kanë pëlqyer fotografitë e tij kur ka qenë fëmijë teksa ka pozuar me fanella të Fenerit. Ka vite që një sulmues i kalibrin të tij i ka munguar klubit tonë", ka thënë Koç.

### Arta Dobroshi viziton FFK-në

Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, e ka pritur sot në takim aktoren shqiptare me famë botërore, Arta Dobroshi. Gjatë këtij takimi kryetari Ademi e ka përgëzuar aktoren Dobroshi për të arriturat në botën e filmit, teksa e ka informuar edhe për të arriturat e FFK-së, sukseset e përfaqësueses si dhe për përkrahjen që i jep KE zhvillimit të futbollit të femrave. Ndërkaq aktorja jonë e famshme uroi që Kosova ta vazhdojë rrugën e suksesit në futboll dhe në të ardhmen e afërt të jetë edhe pjesë e Kampionatit Evropian dhe atij Botëror. Në fund të takimit presidenti Ademi ia dhuroi aktorese Dobroshi një fanellë të përfaqësueses së Kosovës, duke e ftuar të jetë e pranishme në ndeshjet e Kosovës si mysafire e veçantë sa herë që ajo të ketë mundësi.

## Vushtrria prezanton Gavazajn dhe 4 brazilianët

VUSHTRRI, 23 GUSHT - FC Vushtrria ka prezantuar mesfushorin Alush Gavazaj dhe katër futbollistët nga Brazili. Bëhet fjalë për Matheus de Paulan (sulmues 24-vjeçar), Leonardo De Freitas Soares (mesfushor 23-vjeçar), Vgor Vinicius (anësor 27-vjeçar) dhe Ian Augusto (mesfushor ofansiv

23-vjeçar). "Si çdo klub, edhe ne kemi pasur nevojë për përforsime, sidomos në këtë kohë kur Superliga është në valën më të madhe të punës dhe kampionatit. Dihet që pas luftës, kjo do të jetë një Superligë më e fuqishme dhe më ndryshe prej kampionateve të tjerë. Ne kemi mbledhur gjenerata të reja, prej

moshës 18 deri 22, gjeneratë që është në perspektivë dhe presim prej tyre që për një kohë të shkurtër të shpërthejmë. Në anën tjetër, kemi parë që klubi ka nevojë për përforsime andaj kemi kthyer disa lojtarë të Vushtrrisë prej klubeve të tjera", ka thënë Bekim Shotani, trajner i Vushtrrisë.



## Joshua i rrit përqindjen e fitimit, Ruiz pranon ofertën e re

CALIFORNIA, 23 GUSHT - Boksieri meksikan Andy Ruiz Jr ka pranuar marrëveshjen për të dueluar më 7 dhjetor në Arabinë Saudite. Ai ka siguruar nga Eddie Hearn, promotori i ngjarjes, se do të marrë një shumë më të lartë për këtë revansh ndaj Anthony Joshuas. Fillimisht u deklarua se Ruiz do të arkëtonte 9 milionë dollarë,

ndërsa tani kjo shumë është më e lartë (ende nuk dihet saktësisht). Ajo do të konfirmohet zyrtarisht edhe në varësi të shitjeve që do të vijnë nga PPV (pay per view-paguaj për të parë). Ruiz, kampion bote në peshën e rëndë në kategoritë IBF, WBA dhe WBO, do t'i mbrojë titujt që pati fituar më 1 qershor në Nju Jork. Në atë duel ai

mundi me "KO teknik" në raundin e shtatë Joshuab, duke befasuar të gjithë me këtë rezultat. Sipas kontratës së parë, dy boksierët do të zhvillojnë revanshin në rast se Joshua humbet. Gjithsesi, zyrtarizimi ka vonuar të vijë për shkak të përqindjes së titimit. Pritet që palët të dalin brenda javës së ardhshme në një konferencë për shtyp.



## Krasniqi synon ta përfaqësojë denjësisht Kosovën në 'Patra 2019'

PRISHTINË, 23 GUSHT - Notari Arti Krasniqi ka lënë Gjermaninë për ta përfaqësuar vendlindjen e tij, Kosovën. 20-vjeçari, që prej vitesh garon kryesisht në ujëra të gjata, që nga e mërkura ka marrë edhe zyrtarisht të drejtën për ta përfaqësuar vendin tonë në gara ndërkombëtare. Në qershor të këtij viti Arti u bë kampion i Gjermanisë në disiplinën 10 kilometra, kurse për disa vjet fiton Maratonën e Notit Kosova 2019, në distancë 4.2 kilometra. "Ka 2-3 vjet që kam filluar të mendoj të vij të garoj për Kosovën, ndërsa kjo mundësi erdhi tani. E kam pasur edhe pasaportën e Kosovës. Për Gjermaninë kam garuar deri në junior, ndërsa me Kosovën do të garoj për seniorë", ka thënë Krasniqi për "noc-kosovo.org".

Debutimin me Kosovën Arti do ta bëjë javën e ardhshme, ku do të marrë pjesë në Lojërat e dyta Mesdhetare në Rërë "Patra 2019". Ai do të garojë në distancë 5 kilometra. "Do të shkoj të notoj sa më shpejt që mundem, ta jap maksimumin tim. Nuk e di ende se sa e fortë është konkurrenca, por synoj të zë njërin nga pozitat e para. Do të jetë sukses nëse do të jem edhe në 10 më të mirët", thekson Krasniqi, që me prejardhje është nga Prishtina, ndërsa është rritur



dhe zhvilluar në Gjermani. "Patra 2019" nuk është synimi i vetëm me Kosovën për Artin. Atij tani i janë hapur rrugët edhe për gara më të rëndësishme ndërkombëtare, kurse synim mbeten Lojërat Olimpikë "Tokio 2020". "Fillimisht synoj të marr pjesë në kampionate botërore për seniorë, ndërsa synimi kryesor mbetet kualifikimi në Lojërat Olimpikë Tokio 2020. Në Tokio 2020 synoj të kualifikohem

me maratonë ose 1500 metra krol, varësisht ku do të jetë mundësia më e mirë", shton ai.


Në "Patra 2019" Kosovën e përfaqësojnë edhe dy ekipet e beach volleyt: Dhuratë Sylejmani, Valmire Ramadani dhe Faton Mustafa e Armend Berisha.

"Patra 2019" mbahet në qytetin Patra të Greqisë dhe hapet më 25 gusht, ndërsa mbyllet më 31 gusht 2019.

## Rossi: Në Silverstone nis rikthimi im si kampion

NORTHAMPTON, 23 GUSHT - Valentino Rossi beson se gara e radhës e botërorit të Moto GP, në pistën e Silverstones, do të jetë sërish pozitive për të dhe motorin Yamaha. Në garën e fundit në Austri piloti italian u rendit në vendin e katërt. "Në dy garat e fundit motori ka qenë ndryshe, më i shpejtë dhe i fuqishëm. Kemi punuar mirë për t'i bërë ndryshimet e duhura. Fakti që në Austri, një pistë e keqe për Yamaha, ne u paraqitëm mirë, është sinjal inkurajues", ka thënë Rossi.

Gara e radhës në Silverstone. "Ne synojmë që këtë ritëm ta kemi edhe në Angli, një pistë fantastike për mua, të cilën e adhuroj. Pistë e gjerë, teknike, e shpejtë dhe këtë vit me një asfalt të ri. Mezi pres ta provoj. Nëse paraqitemi mirë edhe këtu, atëherë për mua dhe Yamaha



do të jetë një fillim i ri. Shpresoj që kushtet e motit të jenë të mira (vjet u anulua gara prej shiut). Kjo është

një pistë që do t'i testojë pretendimet tona", ka deklaruar Rossi.

### SHKURT

#### Emery: Mustafi dhe Elneny duhet të largohen nga Arsenali

Trajneri Unai Emery e ka këshilluar i mbrojtësin shqiptar Shkodran Mustafi që të largohet nga Arsenali. Emery të njëjtën këshill e ka pasur edhe për mesfushorin Mohamed Elneny. "Vitin e shkuar Mustafi dhe Mo, kur nuk luajtën nuk ishin të lumtur dhe kam folur shumë me ta sezonin e shkuar dhe në parasezonë. Mendoj se është pozitive për ta që të largohen dhe të nënshkruajnë për ndonjë klub tjetër ku mund të jenë protagonistë e të jenë të lumtur e të vazhdojnë karrierat e tyre", ka thënë Emery.

#### Napoli zyrtarizon transferimin e Lozanos

Skuadra e Napolit edhe zyrtarisht e ka transferuar sulmuesin Hirving Lozano nga PSV-ja. Për sulmuesi meksikan, Napoli ka paguar 40 milionë euro dhe në këtë mënyrë ai bëhet lojtari më i paguar në histori të Napolit. 24-vjeçar për skuadrën holandeze ka shënuar 40 gola në 79 ndeshje.

#### Barça refuzon ofertën e Interit për Vidalin

Barcelona ka refuzuar një ofertën e Interit për Arturo Vidalin, ka njoftuar e përditshmja sportive katalane "Mundo Deportivo". Klubi nga Milano ofroi mundësinë e huazimit të mesfushorit kilian, por Barcelona ishte e gatshme të konsideronte vetëm shitjen e tij. Vidal bëri 33 paraqitje në La Ligë për Barcelonën në edicionin e kaluar duke i ndihmuar skuadrës së trajnerit Ernesto Valverde ta mbrojë titullin e kampionit në Spanjë.

#### Navasi largohet nga Reali, shkon te PSG-ja

Portieri Keylor Navas është i vendosur të mbyll aventurën e tij në Real Madridi pas pesë viteve të kaluara, raporton "AS". 32-vjeçari ka mbetur portier i dytë në skuadrën e Realit, pas portierit Thibaut Courtois. Portieri Navas është pajtuar për transferim në Paris Saint-Germain, kurse edhe skuadra spanjolle dëshiron që ai të largohet në mënyrë për të kursyer nga paga e tij.

#### Zidane: Bale nuk do të largohet nga Reali

Trajneri i Real Madridit, Zinedine Zidane insiston se Gareth Bale dëshiron të qëndrojë në Madrid, mes spekulimeve të vazhdueshme për të ardhmen e tij. "Ajo që ka ndryshuar është se lojtari do të qëndrojë, asgjë tjetër. Gjëja e rëndësishme është se lojtari dëshiron të qëndrojë dhe ne do të llogarisim në të. Ai e ka dëshmuar se është lojtar i madh dhe duhet ta dëshmojë edhe një herë këtë gjë. Atë ditë ai luajti mirë dhe jo vetëm në gjërat që është i mirë. Ai punoi shumë në aspektin defensiv. Ne duhet të qëndrojmë në këtë drejtim, edhe Gareth e edhe të gjithë të tjetër. Ne duhet të përmirësohemi për të arritur gjëra të rëndësishme. Dhe të gjithë do ta bëjnë këtë", ka thënë Zidane.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Punëve të Jashtme - Ministarstvo Inostranih Poslova - Ministry of Foreign Affairs  
Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme/Odeljenje za Finansije i Opšte Usluge/Department of Finance and General Services  
Divizioni për Burime Njerëzore/ Divizija za Ljudske Resurse/Division of Human Resources

Duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 neni 15 paragrafi 2 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Ministria e Punëve të Jashtme, shpall:

## KONKURS

### Një(1) Zyrtar i Lartë i Personelit

Departamenti/Zyra: Divizioni i Personelit  
Nr. i referencës: MPJ-DP-001/04  
Koeficienti: 8

### Detyrat Kryesore

- Hartoni planin e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësive dhe jep rekomandime lidhur me realizimin objektivave të njësive;
- Udhëheq grupet punuese në fushën profesionale specifike kur kërkohet dhe kryen detyra të specializuara në fushën profesionale specifike si dhe ndihmon stafin tjetër të institucionit në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre;
- Në bashkëpunim me mbikëqyrësin analizon dhe vlerëson realizimin e objektivave dhe planit të punës të njësive dhe harton raporte mbi progresin e arritur dhe rekomandon përmirësime nëse kërkohet;
- Siguron zbatimin e legjislacionit ligjorë lidhur me menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore;
- Ofron mbështetje profesionale për udhëheqësit lidhur me zbatimin e legjislacionit për menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore;
- Merr pjesë në grupe punuese për hartimin e legjislacionit për burimet njerëzore dhe jep rekomandime për politikën lidhur me menaxhimin e burimeve njerëzore;
- Përgatit raporte dhe përgjigje në pyetjet e parashtruara nga institucionet tjera lidhur me burimet njerëzore;
- Kryen edhe detyra tjera profesionale në pajtim me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat me arsye mund të kërkohen kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

### Shkathtësitë e kërkuara

- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme për menaxhimin e burimeve njerëzore;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

### Kualifikimet dhe përvoja e punës:

- Kualifikime universitare në fakultetin Juridik, Administratë Publike, Shkenca Sociale ose Burime Njerëzore;
- Minimum tre (3) vite përvojë pune profesionale.

### Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve

Kohëzgjatja e emërimit është pa afat - të përhershme (e karrierës) si dhe kohëzgjatja e periudhës provuese është 12 muaj, për pozitën e shpallura me këtë konkurs;

Formularët zyrtar për aplikim merren në Zyrën për Burime Njerëzore të MPJ-së, zyra nr. 04/A, ish-ndërtesa e Eulex-it (rruga Luan Haradinaj nr. 32) gjithashtu mund të tërhiqen edhe nga Ueb-Faqja e internetit të MPJ-së.

Aplikacionet e plotësuara së bashku me kopjet e dëshmive për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kurset e ndjekura, referencat dhe Vërtetimin nga Gjykata që personi nuk është nën hetime etj. mund të dorëzohen:

- Drejtëpërdrejtë në Zyrën për Burime Njerëzore të MPJ-së, dhe
- Përmes postës.

Aplikacioni i dorëzuar pas afatit, i pakompletuar dhe i plotësuar gabueshëm, do të konsiderohet i pavlefshëm dhe nuk do të merret në konsiderim.

Kandidatët duhet të dorëzojnë aplikacione me të dhëna të sakta. Në rast të mosplotësimit të këtyre kërkesave, ose ofrimit të informatave jo të sakta, aplikacioni refuzohet, gjithashtu përdorimi i formularëve jozyrtar rezulton në refuzimin e menjëhershëm të aplikimit.

Aplikacionet e pranuar pas afatit të caktuar, konsiderohen të pranueshme nëse data në dërgesën postare, ose çfarëdo dëshmie tjetër për datën e dërgimit, dëshmon se ajo është dërguar (postuar) para kalimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve.

Kohëzgjatja e emërimit-punësimit bëhet në përputhje me LSHCK, në të cilën është e përfshirë periudha e punës provuese prej një (1) viti.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër/ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit dhe do të jetë i hapur nga data: 24.08.2019 deri më 07.09.2019, në ora 16:00.

Për informata shtesë mund të kontaktoni Zyrën e Personelit të MPJ-së, në telefonin: 038-200-77-073 dhe 038-200-77-118.

Konkursi dhe kërkesa për punësim janë të publikuara edhe në Ueb-Faqen e Ministrisë: [www.mfa-ks.net](http://www.mfa-ks.net)

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Punëve të Jashtme - Ministarstvo Inostranih Poslova - Ministry of Foreign Affairs  
Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme/Odeljenje za Finansije i Opšte Usluge/Department of Finance and General Services  
Divizioni për Burime Njerëzore/ Divizija za Ljudske Resurse/Division of Human Resources

Na osnovu Zakona o civilnoj službi Republike Kosovo i Uredbe br. 02/2010, član 15. stav 2. o procedurama regrutovanja u civilnoj službi, Ministarstvo inostranih poslova, objavljuje:

## KONKURS

### Jedan viši službenik za osoblje

Odeljenje/kancelarija: Divizija za osoblje  
Referentni br: MPJ-DP-001/04  
Koeficijent: 8

### Glavni zadaci

Izrađuje planove rada u saglasnosti sa nadzornikom za sprovođenje utvrđenih zadataka na osnovu ciljeva jedinice i daje preporuke u vezi sa realizacijom ciljeva jedinice #20

Predvodi radne grupe u specifičnoj profesionalnoj oblasti gde je to potrebno i obavlja specijalizovane zadatke u specifičnoj profesionalnoj oblasti, kao i pomaže drugom osoblju institucije u realizaciji njihovih zadataka i odgovornosti;

U saradnji sa nadzornikom analizira i procenjuje realizaciju ciljeva i plana rada jedinice i izrađuje izveštaje o postignutom napretku i preporučuje ispravke ako je to potrebno;

Obezbeđuje sprovođenje pravnog zakonodavstva u vezi sa upravljanjem i razvojem ljudskih resursa;

Pružna profesionalnu podršku za rukovodioce u vezi sa sprovođenjem zakonodavstva za upravljanje i razvoj ljudskih resursa;

Učestvuje na radnim grupama za izradu zakonodavstva za ljudske resurse i daje preporuke za politike u pogledu upravljanja ljudskim resursima;

Priprema izveštaje i odgovore na postavljena pitanja od strane drugih institucija u vezi sa ljudskim resursima;

Obavlja i druge profesionalne zadatke u skladu sa zakonom i trenutnim propisima koji se razumno mogu privremeno zahtevati od strane nadzornika;

### Potrebne veštine

Poznavanje primenljivih zakona i propisa za upravljanje ljudskim resursima

Veštine u komunikaciji, planiranju rada i vodenju tima

Istraživačke, analitičke i ocenjivačke veštine i formulisanje preporuka i profesionalnih saveta

Kompjuterske veštine u radu na programskim aplikacijama (Word, Excel, Power Point, Access)

### Kvalifikacije i radno iskustvo:

Univerzitetske kvalifikacije u pravnom fakultetu, javnoj administraciji, Društvene Nauke ili Ljudskih Resursa.

Najmanje 3 godinac profesionalnog radnog iskustva

### Preuzimanje i podnošenje aplikacija

Trajanje imenovanja je na neodređeno – trajno, dok probni period traje 12 meseci za pozicije koje su objavljene ovim konkursom;

Zvanični obrasci za apliciranje mogu se preuzeti u Kancelariji za ljudske resurse MIP-a, kancelarija br. 04/A, bivša zgrada Eulex-a (ulica Luan Haradinaj bb) takođe se mogu preuzeti sa veb stranice MIP-a.

Popunjene aplikacije zajedno sa kopijama uverenja o potrebnim obrazovnim kvalifikacijama, radnom iskustvu, pohadanim kursovima, referencama i uverenje od suda da osoba nije pod istragom itd., mogu se dostaviti:

- Direktno u Kancelariji za ljudske resurse MIP-a, i
- Putem pošte.

Aplikacije dostavljene nakon roka, nepotpune i pogrešno popunjene aplikacije, smatraće se nevažećim i neće biti uzete na razmatranje.

Kandidati moraju podneti aplikacije sa tačnim podacima. U slučaju neispunjavanja ovih zahteva, ili pružanja netačnih informacija, aplikacija se odbija, takođe upotreba nezvaničnih obrazaca rezultira trenutnim odbijanjem aplikacije.

Aplikacije prihvaćene nakon utvrđenog roka, smatraće se prihvatljivim ako datum na poštanskoj pošiljci, ili bilo koji drugi dokaz o datumu slanja, dokazuje da je aplikacija poslata pre isteka roka za podnošenje aplikacija.

Trajanje imenovanja-zaposlenja vrši se u skladu sa ZCSK-om, gde je obuhvaćen period probnog rada u trajanju od jedne (1) godine.

Samo kandidati koji su izabrani na kraćem/užem spisku biće kontaktirani.



Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja i biće otvoren od: 24.08.2019 do 07.09.2019 u 16:00 časova.

Za dodatne informacije možete kontaktirati Kancelariju osoblja MIP-a na broj telefona: 038-200-77-073 i 038-200-77-118.

Konkurs i zahtev za zaposlenje su objavljeni i na veb stranici Ministarstva: [www.mfa-ks.net](http://www.mfa-ks.net)

“Civilna služba Kosova pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Kosova i pozdravlja aplikacije svih lica muškog i ženskog pola iz svih zajednica na Kosovu”

“Ne-većinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na pravično i proporcionalno zastupanje u organima civilne službe centralne i lokalne javne uprave, kao što je navedeno u članu 11. stav 3. Zakona br. 03/L-149 o civilnoj službi Republike Kosovo.



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIC OF KOSOVO/REPUBLIKA KOSOVA  
 QEVERIA E KOSOVËS/GOVERNMENT OF KOSOVA/VLADA KOSOVA  
 MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE- MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS-MINISTARSTVO  
 ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA

### NJOFTIM PËR ANULIMIN E KONKURISIT

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, bazuar në Rregulloren Nr.02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm të MKRS-së, me Nr.1547/2019 të datës 23.08.2019, bene njoftimin për anulimin e Konkursit të shpallur me datë 27.06.2019, Nr. Refences 25/2019, për pozitën Drejtor i Muzeut Kombëtar të Kosovës (rekrutim i jashtëm).

### OBAVEŠTENJE O ANULIRANJU KONKURSA

Ministrastvo Kulture Omladine i Sporta, bazirajuci se na Uredbu sa Br. 02/2010, o procedurama Regrutacija u Civilnoj Službi, i odluke Generalnog Sekretara MKOS-a, sa Br. 1547/2019, datuma 23.08.2019, obaveštava o anuliranju Konkursa, objavljenog datuma 27.06.2019, sa Br. Preporuke 25/2019, za poziciju Direktor Nacionalnog Muzeja Kosova (javna regrutacija).

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – RËPUBLIC OF KOSOVA  
 KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

**KOMUNA JUNIK**  
 Dt.22.08.2019

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/040, neni 17, Në bazë të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës nenet 7 dhe 8, Ligjit mbi Arsimin Para universitar te Republikës së Kosovës nr 04/L-032, Udhëzimit Administrativ të MASIT-it nr 10/2018, për normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ të MPMS – nr 07/2017, për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Komuna Junik shpallë këtë shpallë:

### KONKURS

Për plotësim e vendeve të lirë të punës për vitin shkollor 2019/2020

#### Shkolla fillore e mesme e ulët "Edmond Hoxha" në Junik

Dy (2) mësimdhënës/e për lëndën Matematikë 28 (20 + 8) orë në javë,  
 Një (1) mësimdhënës/e për lëndën Mësim Zgjedhorë 14 orë në javë.

#### Gjimnazi "Kuvendi i Junikut në Junik

Një (1) mësimdhënës/e për lëndën Matematikë për 20 orë në javë, prej 02.09.2019 deri me 31.05.2020 ( deri të kthet punëtori nga pushimi pa pagës).

#### KUSHTET:

- Për vendin e lirë të punës për mësimdhënës/e kërkohet përgatitja profesionale përkatëse,
- Në mungesë të kuadrit të kualifikuar vijnë në konsiderim kandidatët me kualifikim të përafërt.

#### DOKUMENTACIONI I KËRKUAR:

- Diploma (çertifikata) në origjinal ose fotokopje e vërtetuar nga organi përkatës,
- Çertifikata e lindjes,
- Letërnjoftimi i fotokopjuar,
- Dëshmi për përvojën e punës,
- Dëshmi për trajnimet arsimore,
- Çertifikata e shtetësisë,
- Çertifikata nga Gjykata që nuk jeni nën hetime,
- Vërtetim nga zyra e Punësimin,
- Aplikacioni tërhiqet dhe dorëzohet në Zyrën e pritjes në Junik,
- Dokumentacioni i pakompletuar si dhe ato pas afatit nuk merren në shqyrtim,
- Afati i konkurimit është 15 ditë nga data e shpalljes në gazetën ditore,
- Për ditën e intervistimit, kandidatët do të njoftohen me kohë përmes telefonit.

C.nr.5/2019

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC**, e përbërë nga kryetari i trupit gjykues, gjykatësi Betim Behluli, në çështjen juridike të paditësit Nazim Bellaqa nga fshati Potoqan i Epërm, komuna e Rahovecit, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar avokati Qazim Qeska nga Rahoveci, kundër të paditurës Annita Karin Tirolli nga Trostber Gjermani, për shkak të zgjidhjes së martesës, më 16.07.2019, morri këtë:

### AKTVENDIM

Të paditurës Annita Karin Tirolli nga Trostber Gjermani, i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm avokati Adhurim Bugari nga Rahoveci.


### Arsyetim

Paditësi Nazim Bellaqa nga fshati Potoqan i Epërm, komuna e Rahovecit, kësaj gjykate i ka ushtruar padinë kundër të paditurës Annita Karin Tirolli nga Trostber Gjermani, për shkak të zgjidhjes së martesës.

Në bazë të padisë të paditësit Nazim Bellaqa, kjo gjykatë ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor me datën 16.07.2019, e meqenëse të gjitha shkresat dhe ftesa janë kthyer me konstatim se e paditura Annita Karin Tirolli nga Trostber Gjermani me adresë të pa njohur, e në anën tjetër me propozimin e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, gjykata e miratoi propozimin e përfaqësuesit të paditësit dhe të paditurës Annita Karin Tirolli nga Trostber Gjermani, ia caktoi përfaqësuesin e përkohshëm avokatin Adhurim Bugari nga Rahoveci.

Duke marrë për bazë këtë gjendje faktike e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 79.3 a) të LPK-së, në anën tjetër duke marrë për bazë natyrën e lëndës urgjente, vendosi që të paditurës t'i caktoi përfaqësuesin e përkohshëm.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA RAHOVEC, C.nr. 5/2019, më, 16.07.2019**



### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Luan Elez Kurtaj shpall të pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren
- Valentina Kabashi shpall të pavlefshme dëftesat diplomën, certifikatën, vërtetimin e praktikës SHMM "Luciano Motroni" Prizren
- Sali Kukaj shpall të pavlefshme dëftesat e klasës II - VIII shf "Dëshmorët e Akabashit" Korish
- Blerim Shishko shpall të pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren
- Agron Ninaj shpall të pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren
- Egzon Gutaj shpall të pavlefshme diplomën, dëftesat, certifikatën SHMM "Luciano Motroni" Prizren
- Banesë me qira në Dardani për çif bashkëshortësh. Banesa ka 50 m2 me një dhomë gjumi, sallon e kuzhinë, banjo e ballkon dhe shpajz. Kati i 7 me lift. Çmimi 250 Euro kontakti 044-171328.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një çift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Shitet banesa në Lakërishtë përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.
- Lëshohet me qira banesa në lakërishtë afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

Një vjet pa ty Nënë e dashur!



# Arife (Morina) Krasniqi

(01.09.1949 - 24.08.2018)

Edhe pse je në atë botë, ne këtu ndiejmë mall, mall që kurrë nuk do të shuhet. Pusho e qetë Nënë, se ne nuk do të harrojmë kurrë. Vdekja jote është mungesë e pazëvendësueshme, dhembje e pashëruar. Malli për ty do të mbetet gjithmonë pjesë e jetës sonë. Vlera jote është e madhe. Atë e dimë vetëm Ne që mbetëm pa ty, e që nuk mund të pajtohemi se nuk të kemi më.

*Më mall të pashuar të kujtojnë: Djemt, vajzat, rejat, nipat dhe mbesat nga Tërpeza e Malishevës, Gjermani, Suedia, Franca e Prishtina.*